




*Wibulesa
është natyrrshme*



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 07-08 (470-471)
Korrik-Gusht, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Rreth debatit për mbulesën e gruas në Islam / Mehmet Disha

8 Domethënia e hixhretit profetik / Taulant Bica

10 Lajme / Aktivitete



14 Fol mirë se bëhet mirë / Nuredin Nazarko

16 Edukimi fetar merret që në barkun e nënës / Ana Haxhiu

20 Roli i fesë, ndikimet e kohës dhe sfidat e modernitetit / Gëzim Tushi

24 Vlerësimi i diturisë sipas fesë islame / Xhemal Balla

26 Kurban Bajrami është festa që simbolizon dashurinë / H. Bujar Spahiu

28 Sakrifica e Kurban Bajramit – Retrospektivë



32 Bajram Haxhiu, figurë emblematike e çështjes kombëtare shqiptare / Qerim Haxhi

34 Edukimi i fëmijës me emrat e bukur të Zotit / Aisa Kokçi

36 Falja dhe apotoza / Nilufer Demi

34 Elefanti hero



*Rreth debatit për
mbulesën e gruas në Islam*



Debati rreth çështjes së mbulesës së gruas që Islami përfshin në urdhëresat fetare, nuk ka qenë ndonjëherë debat me nivel konstruktiv dhe me sinqeritet, porse më shumë sheh këndvështrimet e estetikës dhe të feminizmit në bazë interesash, dhe me të njëjtën formë, rikthehet herë pas here në përditshmëri. Madje çuditërisht, kjo tematikë, më shumë vë në angazhim burrat. Ata që polemizojnë duke e kundërshtuar si urdhëresë, nuk e kanë hallin tek e mira e modelit të gruas, as të fëmijëve nëpër shkolla, sepse gjithë ky ngërç që po kalon sistemi i arsimit në vendet tona shqiptare, nuk lë hapësirë për debate të tilla. Këto qëndrime dhe projektligje nuk janë as atdhetare, se gratë e modelit tradicional shqiptar nuk janë zhveshur ndonjëherë, e me këtë logjikë do na duhet të shkojmë gjer në prehistori. Thjesht as nuk kanë ndonjë filozofi tjetër, apo argument, përveç logjikës së tyre, që e shumta është e ngjyer me demagogji e cila, nuk bën kuptim po të shohim, me të njëjtën logjikë, raste të tjera ku sot modeli i gruas është ikonë e marketingut duke shfrytëzuar tërheqjen pamore që trupi i saj i zhveshur (gjysmë, apo gati-gati krejt...) ka për syrin njerëzor.

Pra, kemi sërish një rast ku disa njerëz me opinionin e tyre dalin e propozojnë modelin e tyre se si duhet të vishet gruaja apo vajza në shkolla dhe në ambiente publike, dhe që mohojnë modelin fetar të paraqitur prej Zotit.

Sigurisht, në rrjetet sociale të gjithë mund të japin mend, por këtu rasti në fjalë është rreth mendimit që disa të quajtur si analistë, gazetarë, apo edhe politikanë që kanë qasje në media dhe në një masë të gjerë audience, kanë mbajtur e vazhdojnë të mbajnë qëndrime që në të vërtetë nuk janë pjesë e ndonjë filozofie konkrete, por janë thjesht pasojë e islamofobisë dhe kjo shfaqet qartë. Kjo gjë tashmë po rritet gjer në nivel politikash e ligjesh shtetërore, gjë që cënon të drejtat dhe liritë e individit.

Specialistët e marketingut, për shembull, e dinë mirë se trupi i një gruaje me huret dhe hijeshinë e shtatit është tërheqës për syrin, mirëpo, kur u prishen interesat dhe kur vjen puna tek feja, dalin e kundërshtojnë se nuk na qenkësh tërheqës, e që na qenkësh, përnjëmend, njëlloj më të burrit, dhe me nuancat e feminizmit kërkojnë njëfarë barazie, në një shoqëri ku vajzat janë në pjesën më të madhe të klipeve muzikore duke kërcyer e bërë gjeste alla pornografike dhe që u paraqiten si model të rinjve e të rejave, janë në cdo reklamë e poster të afishuar, sidomos gjatë verës, kuptohet. Po si nuk i shqetësovan këto të fundit, por i shqetëson mbulesa që në Islam është zgjedhje e individit?

Emisionet televizive janë një tjetër shembull se si modeli i vajzave dhe i gruas keqpërdoret dhe u paraqitet si ideal të rinjve e të rejave, ku ndërkohë ato lloj emisionesh nuk kanë asnjë pikë morali dhe etike, janë shthurje dhe djallëzi e gjallë! Madje aktualisht një



peticion shumë i duhur po qarkullon për të ngritur zërin e qytetarëve kundër këtyre pahijeshive që televizionet po u servirin teleshikuesve.

Duhet të kuptojmë se nuk është e lehtë të lozësh me çështjen e lirisë në kohët e sotme ku po i vëzhgojmë mirë sjelljet njerëzore nën pretendimin modernist të konceptit të lirisë. Ka gjëra të dëmshme atje jashtë që sjellin pasoja negative sociale e psikologjike në dëm të individit dhe shoqërisë. Nuk mund të heshtim ndaj këtyre ndikimeve jo të sakta e të bazuara në hamendje individësh me diploma.

Islami është emërtimi dhe cilësia e një përmbledhjeje vlerash të përkryera e të pareduktueshme, pa kurrfarë të mete a mangësie, e cila do t'i përgjigjej çdo nevojë të çdo shoqërie që ka ardhur dhe do të vijë mbi rruzull gjer në kiamet. Për rrjedhojë, kush bën pjesë në këtë fe duhet të jetë pandërprerë në kërkim të përsosurisë dhe plotërisë, me një fjalë, të asaj ç'është e përkryer e që nuk ka as të metën më të vogël.

Mbulesa për gruan është urdhër i qartë i Allahut në Kur'an dhe vjen fill pas një ajeti që në fillim urdhëron besimtarët që të mos shikojnë e të hapin sytë drejt grave e vajzave në mënyrë të pakontrolluar dhe të bien pre e asaj tërheqjeje që folëm më lart e që askush nuk po e konteston në ditët e sotme, madje ajeti u thotë edhe burrave që mbulojnë pjesët e trupit tuaj deri në njëfarë mase të caktuar, e pas kësaj, Allahu thotë: "Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të venë vellot e tyre mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet..." (Kur'an, 24:31).

Krijuesi i gjithësisë dhe i gjithçkaje që ka në të, jep urdhëresa dhe dituri në bazë të natyrës në të cilën Ai e ka krijuar njeriun, dhe bën përcaktime në bazë të gjinive pa i bërë padrejtësi asnjërës palë. Mbulesa është natyrshmëri që e kërkon natyra e gruas në të cilën është krijuar.

Në Kur'an Allahu thotë se nuk ka detyrim në fe. Kjo do të thotë se çdo urdhëresë është për atë që zgjedh me vullnetin e tij të ecë drejt rrugës që Zoti e fton. Njeriu mund të zgjedhë edhe të ecë drejt mendimeve të veta, apo cytjeve dhe ftesave që i bën djalli. Por, kushdo kupton dhe pranon se Krijuesi ekziston dhe është Ai që e mirëmban ekzistencën në vijueshmëri dhe është Suprem, i Plotfuqishëm mbi gjithçka, atëherë i ndjek urdhërimet e Tij dhe i merr ato për bazë, sepse e di mirë që veç Krijuesi e njeh më së miri krijimin e Tij. Kjo do të thotë se pikë së pari, besimi dhe feja është një zgjedhje mes individit dhe Zotit të tij, ku askush nuk ka të drjtë të ndërhyjë.

Gjithsesi, e shumta që mund të bëjë njeriu i kohës në këtë Univers është të sodisë, të sajojë me dijet e tij mjete për të parë - zgjatime të vështrimit të tij - dhe të kuptojë sa i vogël e sa i përkohshëm është. Sa më shumë që shtohet qartësia e teleskopëve (apo edhe e mikroskopëve), aq më shumë shtohet fusha e pafuqisë së tij, aq më shumë zvogëlohet fusha e ndikimit të tij. Këtë na e vërtetoi edhe së fundmi NASA me teleskopin "James Ëeb" që shkencëtarët e saj sapo nxorrën: vetëm sa e shohim më bukur madhësinë e krijimit të Krijuesit! Ata që nuk duan të besojnë e as të ndjekin një fe, cilëndo, dhe ata që nuk e besojnë Krijuesin e botën tjetër, sigurisht që do ta kundërshtojnë modelin e jetesës që paraqet feja. Ata duan lirinë absolute, e cila është skllavëri totale ndaj dobësive njerëzore, dhe filozofia e zhveshjes nuk

është pjesë e ndonjë skeme madhore që projekton një model jetese ideale, është thjesht një zgjedhje ashtu kot, sa për të thënë që “zgjedhja” dhe aq, pa ditur më tej se ç’përgjegjësi vijnë më pas. Madje e shohim këtë lloj filozofie si filozofi që e çon njeriun drejt papërgjegjësisë totale në lidhje me botën, e që përfundon në gjëra akoma më të dhimbshme për njerëzit që e ndjekin dhe tashmë, i dimë e po i shohim përditë përfundimet e asaj rrugë që ruana Zot!

Mes gjithë këtyre debateve që bëjnë në vendin tonë për Islamin dhe për parimet e Kur’anit, sidomos për mbulesën, nga njerëz që e kanë zgjatimin e arsyes në cep të qerpikëve dhe që aq gjë dinë për Islamin, u themi tani për tani:

Ai që e ka urdhëruar mbulesën për gruan, është Ai që e ka krijuar atë dhe e ka vendosur në këtë planet nëpërmjet një procesi që njerëzimi shumë pak e merr vesh, thjesht mund ta shohë, duke vëzhguar me mikroskopë se si prej një fare të vogël, ngjizet njeriu në barkun e nënave dhe vjen në jetë me një program organesh dhe gjymtyrësh të mrekullueshme, dhe e ka bërë planetin të sillet përreth një dielli që është burim jete me dritën, nxehtësinë, rrezatimin që përçon dhe forcën gravitacionale të mbajtjes dhe të mirëpeshimit, e ka vendosur sistemin diellor në një orbitim të përpiktë brenda rrugës së Qumështit dhe që udhëtojnë bashkë përreth qendrës së Universit; Ai Krijues që gjithçka që krijon e krijon bukur e hijshëm dhe që ka vendosur bukuri artistike dhe mrekulli detajistike në çdo atom, dhe që Drejtësia e Mëshira e Tij pasqyrohet kudo në çdo sferë të jetës, pikërisht Ai, Allahu jep urdhëresa për të mirë dhe ndalon nga e keqja si udhëzim për njerëzimin! Me ç’pretendim dilni e jepni mend se si duhet të jetojë

gruaja apo burri në jetë, ku e gjeni guximin? Ku e njihni ju krijimin dhe sa jeni të aftë të kontrolloni universin dhe punët që qarkullojnë në të?

Ja, paraqitja e Krijimit nga Kur’ani:

“Qoftë i lartësuar Ai, në dorën e të Cilit është pushteti suprem dhe që është i Fuqishëm të bëjë çdo gjë!

Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.

Ai ka krijuar shtatë qiej nërin mbi tjetrin. Nuk mund të gesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë të mete (cenimi). Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje?


Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur.

Ne jua kemi zbukuruar qiellin më të afërm me yje të shkëlqyeshme dhe i kemi bërë ato si predha për të larguar djajtë, për të cilët kemi përgatitur dënimin me zjarr...” (Kur’an, 67:1-5)

Kështu, të gjithë ata që kanë dyshime rreth urdhëresave të Allahut në Librin e Tij të qartë e madhështor, e që i përcolli aq denjësisht duke i shpjeguar me përpikmëri me anë të Profetit Muhamed a.s., le të shohin gjurmët dhe shenjat e Krijuesit në univers, le të shohin argumentet e qarta të rrugës së duhur që duhet kur të japin mend prej filozofisë dhe të menduarit kritik që buron prej tyre, apo që ka buruar prej të tjerëve që kanë patur mendimin se ata mund ta gjenin vetë arsyen e jetës dhe të vdekjes, e të ekzistencës mbarë, nëpërmjet fuqisë së tyre dhe që në të vërtetë, ndoqën udhëzime djallëzore dhe qasje të mendjeshkurtësisë.

Zoti e di më së miri!

DOMETHËNIA E *hixhretit Profetik*



Në fillim të çdo hëne të re të muajit Muharrem, jetojmë në përkujtimin e Hixhretit Profetik. Në brendësinë e qenies sonë ngjallet ndjenja e sakrificës dhe idealeve më të larta, shfaqet besimi i pastër, shkreprijnë rrezet e përpjekjeve dhe kumbon fuqishëm zëri i arsyes dhe i së vërtetës.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Në mos e ndihmofshit atë (Profetin), atë e ka ndihmuar Allahu; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin..." (Teube, 40)

Nga mundimet dhe persekutimet e mëdha që përjetonin myslimanët prej idhujtarëve, u detyruan që fshehtas, grupe-grupe ta linin Mekën dhe t'i drejtoheshin Medinës, për të gjetur shpëtim, prehje dhe qetësi, ku do të mundnin lirisht t'i shprehnin ndjenjat e tyre fetare. Mirëpo jobesimtarët i shqetësonte përhapja e dritës. Mundoheshin me çdo mjet e metodë ta shuajnë atë. Planet dhe orvajtjet e tyre Profeti ia zbuloi Krijuesi i gjithësisë, Allahu Fuqiplotë, i cili në Kur'an thotë: "Përkujto (o Muhamed) kur ata që nuk besuan, thurnin (komplete) kundër teje, të të ngujojnë, të të mbysin ose të dëbojnë, ata bënë plane, e Allahu i asgjësonte (ato plane e kurthe), se Allahu është asgjësuesi më i mirë (i dredhive-intrigave)". (Enfal, 30)

Kështu, Profeti së bashku me shokun e tij Ebu Bekrin largohen nga Meka. I frikësuar për jetën e profetit, Ebu Bekri do t'i thoshte: "O i Dërguar, nëse të ndodh gjë ty, Islami do të fshihet nga faqja e dheut". Mirëpo si çdo herë, fjalët e Profetit do të ishin si balsam dhe do ta qetësonin Ebu Bekrin: "O Ebu Bekër, çfarë mendon për dy vetë, i treti i të cilëve është Allahu, prandaj mos u dëshpëro dhe mos u frikëso se Allahu është me ne, Ai na mbron dhe përkujdeset për ne".

Në të vërtetë ndihma dhe përkrahja e Krijuesit të gjithësisë, e cila asnjëherë nuk u ka munguar robërve të Tij të devotshëm, nuk mungoi edhe kësaj radhe. Në Kur'an lexojmë: "...e kur ata të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të tij: mos u pikëlloni (dëshpëro), Allahu është me ne! E Allahu i zbriti qetësi (prehje) në shpirtin e atij, e furnizoi me një ushtri që ju nuk e patë..." (Teube, 40)

E më në fund, do të shndrisë dielli shkëlqyes e plot dritë i tij me tërë atë bukurinë magjepsëse.

Në Kur'an thuhet: "E fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ulët, kur fjala e Allahut është më e larta, sepse vetëm Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." (Teube, 40)

Fjalët e Allahut janë më të lartat, sepse janë të shenjta; janë burim i pashtershëm i së vërtetës, i dritës dhe i udhëzimit; janë baza e moralit të përkryer, ashtu siç janë ideal i përhershëm i rrugës së shpëtimit dhe i fatbardhësisë njerëzore deri në amshim. Kurse fjalët e jobesimtarëve janë të ulëta, të pavërteta, të errëta dhe pa vlerë. Ato çojnë në humbje e në shkatërrim, në zhdukje e degradim. Fjala dhe Drita e Allahut do të plotësohen dhe përhapen pa marrë parasysh mërinë dhe urrejtjen e idhujtarisë.

Hixhret do të thotë: largim, shpërngulje, kalim, braktisje dhe ndarje nga diçka. Shpërngulja e bekuar e Muhamedit a.s nga Meka për në Medinë, me urdhër të Allahut të Madhëruar, ishte shpërngulje me qëllim kthimi, sepse i dërguari i Zotit, duke dalë nga Meka, me lot në sy tha: "Mekë, o vendlindja ime e shtrenjtë, kurrë nuk do të kisha lënë, po të mos më detyronin të të lë". Ai kurrë nuk do ta

harronte Mekën, derisa e çliroi njëherë e përgjithmonë nga prangat e idhujtarisë, tetë vjet pas hixhretit.

Kjo u bë e mundur, sepse hixhreti i Muhamedit a.s dhe i myslimanëve të tjerë, nuk ishte shpërngulje e "bijve dhe e shpirtrave të trazuar" nga frika për jetën e tyre, siç mund të përpiket ta përshkruajë dikush, shpërnguljen e tyre të bekuar.

Hixhreti nuk ishte as ikje e as humbje e së vërtetës para urrejtjes hakmarrëse të jobesimtarëve, por ishte vendosmëri e paluhatshme dhe fillim i një rreshtimi të ri për thyerjen përfundimtare dhe ngushtimin e veprimit të jobesimtarëve; ishte rrugë e përhapjes dhe shtrirjes së dritës së besimit, dritë të cilën e kishin penguar idhujtarët plot trembëdhjetë vjet, me qëllim që ta zhduknin nga faqja e dheut.

Po qe se hixhreti do të ishte ikje nga frika, besimtarëve nuk do t'u arinte ndihma dhe përkrahja e Allahut Fuqiplotë, sepse Ai nuk i ndihmon e as nuk i lartëson frikakakët dhe të pavendosurit. Allahu dëshiron që besimtarët të jenë të fortë, të paepur e të vendosur në besimin dhe durimin e tyre.

Hixhreti ishte një planifikim i urtë dhe largpamës, ishte fillimi i një beteje ndërmjet dritës dhe errësirës, ishte shpërngulje e njerëzve drejt lirisë, fisnikërisë dhe dinjitetit, ngritje në çiltërsinë dhe dëlirësinë shpirtërore dhe shpëtim i ndërgjegjeve të pastra.

Hixhreti, në shikim të parë, ishte kalim nga një vend në një vend tjetër, kurse në esencë shpërngulje nga dobësia në fuqi dhe nga pesimizmi në shpresë, për një ardhmëri më të lumtur e më të shndritshme të Islamit.

Për këtë arsye Allahu i Madhëruar ia lejoi hixhretin të dërguarit të Tij. E rezultati nuk vonoi. Puna e parë e Muhamedit a.s. pas arritjes në Medinë, ishte vëllazërimi i myslimanëve – ensarëve (banorëve) të Medines dhe muhaxhirëve (të shpërngulurve) të Mekës, që u pasua nga ndërtimi i xhamisë, e cila do të ishte fanar ndriçues nga ku do të rrezatonin rrezet e dritës së udhëzimit të vërtetë. Në Kur'an thuhet: "Vërtet, Allahu do t'i ndihmojë atij që ndihmon (në) rrugën e Tij, se Allahu është Fuqiplotë dhe i Plotfuqishëm". (Haxh, 40)

Përkujtimi i hixhretit në fillim të çdo viti, na bën më të ndërgjegjshëm për rëndësinë e përpjekjes në rrugën e Allahut, në rrugën e thirrjes në Islam, në rrugën e paqes dhe tolerancës, dashurisë dhe respektit të thellë ndaj çdo njeriu. Na përkujton gjithmonë fitoren e lavdishme të Dritës ndaj errësirës, triumfin e besimit ndaj të kotës dhe të keqes.

Për këtë Allahu i Plotfuqishëm thotë në Kur'anin Fisnik: "Ai (Allahu) është që e dërgoi të dërguarin e Vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë, për ta mbizotëruar mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë". (Saf, 9)

Besimtarët e ndershëm duhet ta jetojnë hixhretin, duke ruajtur me kujdesin më të madh mesazhin e tij, duke bërë hixhret të vazhdueshëm (largim-shpërngulje) nga e keqja në të mirë, nga e pavërteta në të vërtetë, nga veprat e shëmtuara në ato të lavdëruara, nga koprracia në bujari, nga ngushtësia në zemërgjerësi, nga tradhtia në besnikëri, nga dyfytërsia në sinqeritet dhe çiltërsi shpirtërore dhe nga robëria e mohimit në lirinë e besimit.



1

"WATER FOR LIFE"

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Fondacionin "Swiss Barakah" dhurojnë për besimtarët e një qyteti në Sri Lanka një pus uji të pijshëm dhe kanë ndërtuar gjithashtu abdes'hane në shërbim të besimtarëve.

Swiss Barakah është një fondacion humanitar me qendër në Zvicër.

Komuniteti Mysliman ka prej kohësh një bashkëpunim të ngushtë institucional, në drejtim të aspektit humanitar, me këtë fondacion. Edhe ky bashkëpunim është i tillë, për t'i dhënë vazhdimësi dhurimit, ndihmës dhe mirëbërësisë si shfaqje të mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit.

Profeti Muhamed (a.s.) sadakanë rrjedhëse e ka krahasuar me lumenj dhe çezma që vazhdojnë të rrjedhin qysh kur është krijuar bota. Ne shresojnë që i tillë të jetë ky vakëf në këtë komunitet në Sri Lanka.

Falë Zotit ne jetojmë në një vend që ka ujë me bollëk, mirësi e Zotit, por në vende të tjera të botës, si rasti në fjalë, hapja e një pusi uji të pijshëm është një nga nevojat jetësore për popullatën.

Duke falenderuar me mirënjohje fondacionin zvicerian "Swiss Barakah" për bashkëpunimin e ngushtë, ne lutemi që Zoti t'ua pranojë sadakanë gjithë kontribuesve në këtë vakëf dhe kjo t'i shërbejë më së miri komunitetit për të cilin është dhuruar.

2

MBYLLET FUSHATA E DHURIMIT TË GJAKUT NË NDIHMË TË FËMIJËVE TALASEMIKË

Ftesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për të dhuruar gjak në ndihmë të fëmijëve talasemikë, ju përgjigjen jo vetëm stafi i institucionit por edhe dhjetëra besimtarë e qytetarë të ndryshëm të Tiranës.

Që nga nisja e saj në muajin Maj, kjo fushatë u shtri në xhami të ndryshme të Kryeqytetit, ku besimtarë të shumtë dhanë kontributin e tyre në këtë kauzë kaq fisnike, për tu mbyllur në ambientet e institucionit.

Talasemia është një ndër sëmundjet më të shpeshta të gjakut, që ka përhapje masive edhe në Shqipëri, duke përfshirë më së shumti fëmijët.

Nevojat e tyre janë më të shumta se sa dhurimet vullnetare të gjakut në vendin tonë, ndaj Komuniteti Mysliman fton të gjithë besimtarët ti bashkëngjiten kësaj kauzë jetike për fëmijët të cilët vuajnë nga kjo sëmundje.

Allahu (xh.sh) i shpërbleftë të gjithë ata që dhuruan!





3

"ANGAZHIMI I TË RINJVE PËR NDËRTIMIN E NJË KOMUNITETI TË QËNDRUESHËM"

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA në Tiranë organizuan një aktivitet në lidhje me projektin "Angazhimi i të rinjve për ndërtimin e një komuniteti të qëndrueshëm". Ky aktivitet u organizua në kuadër të implementimit nga KMSH të fazës tre të këtij projekti, i cili financohet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.

KMSH ka ndërmarrë implementimin e këtij projekti me qëllim promovimin e vlerave demokratike dhe nxitjen e qytetarisë aktive në mesin e të rinjve në disa qarqe të Shqipërisë.

Nëpërmjet një serie seminaresh, workshop-e, aktivitetesh sociale dhe kulturore, ky projekt ka ofruar njohuri mbi parimet demokratike, të drejtat e njeriut, detyrat dhe përgjegjësitë qytetare, mbi tolerancën dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis të rinjve.

Në këtë projekt janë përfshirë një numër i madh të rinjsh, të cilët kanë përfutur në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe një numër i konsiderueshëm të rriturish në zona të ndryshme të vendit. Objektivi kryesorë është zhvillimi i të menduarit kritik tek të rinjtë si dhe rritja e qëndrueshmërisë në komunitete, për t'i bërë ballë ideologjive radikale dhe ekstremiste.

Parandalimi i këtyre fenomeneve kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve.

Kjo na ndihmon që të rrisim aftësitë tona të reagimit ndaj këtyre fenomeneve në kohë e duhur.

Koordinatori i këtij projekti nga KMSH është Drejtori i Marrëdhënieve me Jashtë, z. Fezi Shaholli.

Në këtë aktivitet morën pjesë gjithashtu z.Keith West Officer Politik i Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, nënkryetari i KMSH-së, z.Tauland Bica, nënkryetari i Bashkisë Kurbin z.Eduart Kurti, Shefi i Njesisë Rajonale të Antiterrorit, z.Meçan Bakushi, Sekretari i Përgjithshëm i KNFSh, Dr.Genti Kruja, si dhe z. Ali Zairi lektor në Kolegjin Universitar Bedër.

Aktiviteti u zhvillua në qytetin e Laçit.





4

BEDËR DIPLOMON BREZIN E 9-TË TË STUDENTËVE

Kolegji Universitar Bedër diplomoi brezin e nëntë të studentëve në 8 programe studimi bachelor dhe 10 programe master. Përplot 247 studentë mbyllën me sukses rrugëtimin akademik dhe tashmë janë të gatshëm që dijet e fituara në këto vite t'i vënë në shërbim të vendit dhe shoqërisë.

Të pranishëm në ceremoni ishin prindër, familjarë, drejtues të institucioneve të ndryshme, të ftuar, pedagogë dhe anëtarë të tjerë të Kolegjit Universitar Bedër, etj. Fjalën e hapjes e mbajti Rectori i "Bedër", Prof. Dr. Gjergj Sinani, i cili uroi studentët dhe shprehu bindjen se ata do të jenë një vlerë e shtuar për të gjithë.

I ftuar nderi në ceremoni ishte Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili vlerësoi rezultatet e arritura nga Kolegji Universitar Bedër. Në fjalën përshëndetëse Kryetari i KMSH-së i bëri thirrje të drejtëpërdrejtë të rinjve të sapodiplomuar që të mos e braktisin vendin e tyre, por kontributin ta japin për zhvillimin e tij.

Më pas ceremonia vazhdoi me përshëndetjet e dekanëve, të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi dhe të Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit, Prof. Asoc. Dr. Tidita Abdurrahmani.

Certifikatat për studentët e ekselencës u shpërndanë nga Prefekti i Qarkut të Tiranës, z. Afrim Qëndro.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë i uron suksese të mëtejshme studentëve brezit të nëntë të diplomuarve!

5

570 BESIMTARË KRYEJNË HAXHIN

Pas 2 vitesh ndërprerjeje si pasojë e pandemisë Covid-19, këtë vit Zoti bëri të mundur që Haxhi të kryhet dhe masat të lehtësohen, kështu Komuniteti Mysliman i Shqipërisë organizoi udhëtimin e Haxhit për rreth 570 besimtarë të cilët zgjodhën të kryenin ritualin fetar që është një nga pesë shtyllat themeltare të fesë Islame.





6

MIJËRA BESIMTARË MYSLIMANË FESTOJNË KURBAN BAJRAMIT

Mijëra besimtarë myslimanë mbushën sheshin "Skënderbej" dhe gjithë sheshet e xhamitë e vendit për faljen e Kurban Bajramit. Programi i Kurban Bajramit në kryeqytet filloi që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut, për të vijuar më pas me këndimin e një pjese nga Kurani Famëlartë, të cilën e përcolli për besimtarët e pranishëm hafizi Enes Hyka.

Ceremonia vijoi me fjalën përshëndetëse të Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili përcolli mesazhe të shumta urimi e solidariteti.

Pas faljes së namazit, në orën 06:05, të cilin e priu kryetari Spahiu, programi vijoi më tej me Hutben e Bajramit që u mbajt nga Nënkryetari i KMSH-së, z. Taulant Bica.

Më pas besimtarët e pranishëm në shesh u shpërndanë për të festuar me familjet dhe të afërmit e tyre.

Pas përfundimit të faljes së Kurban Bajramit në "Sheshin Skënderbej", Komuniteti Mysliman i Shqipërisë hapi dyert për të pritur vizitat tradicionale me rastin e kësaj feste.



FOL MIRË SE
BËHET MIRË

Fjala e thënë ka peshë të madhe. Nuk është e lehtë të flasësh edhe pse duket gjëja më e thjeshtë në botë dhe më e arritshmja nga të gjithë. Kushdo që mendon të kundërtën le të provojë të flasë mbi një temë të caktuar para një auditori, për një kohë të caktuar. Dilema fillon që në përzgjedhjen e tematikës e mbaron tek shqetësimi se si u prit fjala e thënë nga dëgjuesit. Mjafton vetëm ky shqetësim, pa marrë në konsideratë pjesën tjetër, për të kuptuar se sa e vështirë është të flasësh për të mirën, të drejtën. Vështirësia rritet për faktin se kur flasim mendojmë se sa do të arrijmë të kemi koherencë mes fjalëve dhe veprave. Është më e lehtë të teorizosh se sa të veprosh, por veprimi varet nga mendimi dhe mendimi nga leximi.

Përgjatë jetës njeriu që lexon, apo dhe ai që është dëgjues i mirë i diskutimeve të njerëzve që lexojnë e diskutojnë vazhdimisht, pasuron fondin e fjalëve. Kjo pasuri e bën më të zhdërvjellët në shprehjen e mendimit dhe në komunikim. Njeriu njeh dhe kupton fuqinë e fjalës, veçanërisht kur sheh se si njerëz të ndryshëm ndikohen në mendimet e tyre nga fjala e thënë dhe ndryshojnë edhe veprimtarinë e tyre jetësore në sajë të këtyre ndikimeve. Ndikimet mund të jenë negative, ose pozitive. U përmend negativiteti si fillim, sepe në ditët që jetojmë fjalët pozitive përdoren gjithmonë e më rrallë. Fjala e mirë qarkullon në mjedise të kufizuara. Mbizotëron përdorimi i keq i gjuhës së folur, por edhe i asaj të shkruar. Duket sikur njerëzit kanë dimra të tërë që kanë mbledhur vrer dhe tashmë ka shpërthyer. Është për të ardhur keq që teksa jetojmë mes mrekullive të natyrës apo shëndetit e kohës që kemi në dispozicion për të ecur drejt së mirës, ndikohemi nga ky vrer që i heq njeriut mundësinë të kridhet në qetësinë e meditim për të shëruar lëngatat e shpirtit më së pari.

Fjala ka ndikim të fortë mbi shpirtin e njeriut. Ajo ose djeg shpirtin, ose e shëron. Fjala e thënë më urrejtje, e mbushur me inat e zemërim është tepër sflitëse për shpirtin që i adresohet, veçanërisht për shpirtat e ndjeshëm dhe të mirë. Sa e sa njerëz ndihen keq vetëm sepse gjenden në një mjedis ku përdorimi i keq i gjuhës ua heq edhe ato pak rreze dielli që përpiqet të gjejë shpirti i tyre. Sa e sa njerëz zhvillojnë brenda vetes pesimizmin për të ardhmen, për suksesin në shkollë apo punë vetëm prej fjalëve fyese dhe përçuese që denigrojnë që në embrion përpjekjet për t'u


ngjitur në sferat e mirësisë. Sa e sa njerëz rëndohen edhe më shumë shpirtërisht nga komunikimi pa etikë, i ashpër dhe mizor. Sa e sa njerëz fokusohen në ditët e tyre rreth fjalëve negative në adresë të tyre, duke harruar dritaret e tjera të jetës. Dikush mund të thotë se duhet t'i marrin gjërat me sportivitet, se kështu është e nuk bëhet ndryshe. Po pse duhet të pranojmë një realitet fyese e përçmues dhe ta bëjmë lëkurën si shuall opinge përballë përdorimit të keq të gjuhës së folur? Përse të mos përpiqemi të ndërtojmë një realitet ku fjala e mirë, etika në komunikim dhe bonsensi të zënë vendin e urrejtjes dhe ligësisë?

Që të bëhet mirë duhet të flasim mirë. Të ngjallim shpresë, optimizëm. Të çelim dritare të reja prej të cilave të shohim dhe anë të tjera të jetës. Të gëzojmë me fjalë të mira dhe të ëmbla, zemrat e lodhura, shpirtat e nxirë nga bloza e një komunikimi që djeg e përcëllon si zjarri. Të krijojmë një klimë butësie e paqeje përmes fjalës së thënë, por edhe të mos lejojmë që fjalët negative të depërtojnë në këtë hapësirë dhe të mjegullojnë shkëlqimin e këtij mjedisi që ndrin nga prezenca e shpirtave të pastër e të dëlirë.

Zemra e njeriut e ndjen ndryshimin mes të qenit në një mjedis që fjala e errëson dhe e rëndon dhe një mjedis që fjala e bën të rrezatojë mirësi. Nëse është kështu, përse të mos bëjmë përpjekje maksimale për të dhënë sadopak kontributin tonë në krijimin e një realiteti ku mbizotëron dashuria ndaj së mirës, por jo loja në kurriz të saj. Përse të mos kontribuojmë me sineritet dhe pastërti, edhe pse do të ketë njerëz që do të duan ta prishin atë që të mirët ndërtojnë? E keqja mund të mbizotërojë në periudha të caktuara, por kurrë nuk mund të fitojë në mënyrë përfundimtare ndaj së mirës. Prandaj le të jemi në anën e së mirës me fjalën e mirë, me vepra të mira, me dhënien hakut gjërave ashtu si e meritojnë. Duke u përpjekur të gjithë nga pak, bëhet shumë në vazhdimësi. Le të jetë fjala jonë ashtu si farat e bimëve të cilat edhe kur mbillen mes gurëve e ferrave japin gjithmonë frute shumëfish. Shumëfishimi i të mirave nuk mund të ndodhë vetëm se kur shpirtat njerëzorë nxiten për të punuar nga fjala e mirë. Të flasim mirë edhe sikur të jemi të fundit që do të duhet ta bëjmë këtë. Ta konsiderojmë të folurit mirë si mision të jetës dhe jo thjesht një detyrë që duhet përmbushur. Vetëm kështu do të dijmë të durojmë dhe të ecim para pa u ndalur, edhe nëse shpejtësia e lëvizjes kufizohet nga forcat e fërkimeve.

Edukimi fetar

MERRET QË NË BARKUN E NËNËS!



Jo vetëm zhvillimi fizik dhe mendor, por edhe ai moral dhe fetar është i lidhur me mënyrën e jetesës së nënës gjatë shtatzënisë. Hapat e parë duhet t'i hedhim në këtë fazë, nëse dëshirojmë që fëmija ynë të ketë një zhvillim moral dhe fetar të mirë.

Për të rritur fëmijë të mirë dhe të moralshëm, sipas fesë sonë, nëna që nga shtatzënia duhet të bëjë kujdes me mënyrën e jetesës së saj. Që nga e ngrëna dhe e pira deri te sjelljet ndikojnë në zhvillimin shpirtëror dhe të karakterit të fëmijës në barkun e nënës.

Edukimi i fëmijëve, të cilët Kur'ani Fisnik i përkufizon si "stoli e jetës së kësaj bote", është një çështje e cila zë vend të rëndësishëm në jetën e çdo prindi, sepse është e vështirë të rritet një fëmijë i moralshëm, i dobishëm për shoqërinë. Prandaj, ata të cilët kanë vendosur të bëhen prindër, veprojnë me vetëdijen se po hedhin hapa drejt një procesi të vështirë. Disa lexojnë libra rreth zhvillimit të fëmijëve, disa të tjerë këshillohen me specialistë të fushës. Por, vetëm këto nuk janë të mjaftueshme për të rritur një fëmijë fetar, të edukuar dhe zotërues të vlerave morale. Profeti a.s., i cili është këshilluesi ynë në çdo çështje, në këtë rast edhe në edukimin e fëmijës, thotë: "Ai që është për xhehenem (shakî) është që në barkun e nënës, ai që është për xhenet (sa'id) është që në barkun e nënës", duke na tërhequr vëmendjen se edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës. Pra, feja jonë, e cila i kushton rëndësi të veçantë edukimit të fëmijës, na tregon se të pasurit fëmijë të mirë është në dorë të nënës dhe babait. Teologët thonë se për këtë duhet vepruar sipas "edukatës së shtatzënisë". Edukatën e shtatzënisë e sqarojnë me hadithin e Profetit a.s. i cili thotë: "Gjeni një vend të mirë për farën tuaj (nutfeh), sepse rrënjët trashëgohe". I Dërguari i Allahut a.s. në këtë hadith tregon se morali dhe edukata e prindërve trashëgohet

te fëmija. Prandaj, për të pasur fëmijë të mirë, duhet të fillohet që nga zgjedhja e bashkëshortit/bahkëshortes, e deri te jetesa sipas rregullave të fesë pas shtatzënisë. Diçka tjetër është afrimi i bashkëshortëve sipas traditës profetike (sunsetit), ashtu siç Profeti a.s. ka thënë: "Në emër të Allahut! O Allah, largo shejtanin prej nesh dhe prej atij të cilin ke dhënë të niset (fëmijës)! Nëse Allahu jep që me atë rast të niset ndonjë fëmijë, shejtani nuk do t'i bëjë dëm!" (Transmeton Buhariu dhe Muslimi). Ky është një ndër treguesit se si mënyra e jetesës së prindërve ndikon fëmijën.

Po të shikohet me kujdes, qëndrimin e fesë sonë rreth kësaj teme e mbështesin edhe shumë kërkime shkencore. Kërkimet shkencore në mbarë botën tregojnë se fëmija fillon ta perceptojë botën që nga barku i nënës dhe që në barkun e nënës fëmija formon tridhjetë për qind të personalitetit të tij. Rreth kësaj kemi shumë shembuj nga jeta e prindërve të shumë dijetarëve, nënat e të cilëve gjatë shtatzënisë nuk hidhnin një hap pa abdes, ndërsa pas lindjes nuk i ushqenin asnjëherë duke qenë pa abdes, përveç ditëve të veçanta. Ndërsa baballarët bënin kujdes të mos sillnin furnizim haram në shtëpi, duke bërë kujdes në fitimin e tyre.

Babai i Imam Ebu Hanifes dhe molla

Një ditë, babai i themeluesit të shkollës juridike hanefite Imamu'l-A'dham Ebu Hanifes, Nu'man bin Thabit, kur po merrte abdes pranë një përroi. Sapo do të fillonte të merrte abdes shikon një mollë të cilën e kishte marrë

uji. Pa e menduar se nga vjen, a është hallall apo haram, e kafshon mollën. Deri në atë moment, Nu'mani, i cili nuk e kishte menduar nga kishte ardhur molla, e kupton gabimin dhe mendon se duhet të gjejë të zotin dhe t'i kërkojë hallallin. Ai u nis andej nga vinte uji. Me mollën në dorë, duke kërkuar, gjen bahçen nga ku kishte rënë molla dhe të zotin e saj.

Ia shpjegon situatën dhe i kërkon hallallin. Ky veprim i Nu'manit i tërhoqi vëmendjen të pronarit të bahçes dhe i thotë që për t'ia bërë hallall kishte disa kushte. Nu'mani i thotë që pranon çdo gjë, vetëm t'ia bëjë hallall. Tjetri i thotë që duhet t'i shërbejë atij dy vite duke punuar në bahçen e tij. Nu'mani mendon: Më mirë t'i shërbej dy vite, sesa të vuaj dënimin në botën tjetër dhe pranon.

Pasi dy vitesh shkon pranë të zotit të bahçes, i thotë që koha është mbushur dhe i kërkon hallallin. Burri i thotë: "Sërish nuk ta bëj hallall. Kam një vajzë dhe vetëm po u martove me të do ta bëj hallall". Nu'mani pranon. Por burri i thotë se vajza e tij kishte të meta fizike. Ishte e verbër, e çalë dhe shurdhe. I thotë ta mendojë mirë që të mos pendohet pastaj. Duke menduar sërish si më parë, që më mirë dënimin në këtë botë se në tjetrën, pranoi. Pasi bëhet dasma dhe shikon nusen, mendon se ka ndodhur ndonjë gabim dhe nuk është ajo nusja e tij, sepse vajza që shikon nuk kishte asnjërin prej cilësive që burri i pati thënë. Shkon të pyesë të vjehrrin dhe ai i thotë: "Ime bijë është e verbër, sepse nuk ka parë haram. Është shurdhe, sepse nuk ka dëgjuar haram. Është e çalë, sepse nuk ka ecur në rrugë të ndaluar".

Pasi kaluan vite nga kjo martesë lindi Imam Ebu Hanife. Nëna e tij e dërgon te mësuesi i tij për ta edukuar. Ebu Hanife, i cili më vonë do të merrte titullin "Imamu'l-A'dham", që në moshën tre vjeçare e mbaroi Kur'anin për tri ditë. Për këtë, nëna e tij i tha: "Ah, mor bir! Sikur babai yt mos ta kishte kafshuar atë mollë do ta mbarojë për një ditë".

Sa me ndjeshmëri kanë jetuar njerëzit më parë, saqë për diçka tepër të vogël, që mund të duket e parëndësishme tregonin kujdes dhe largoheshin nga të ndaluarat. Pikërisht prej atyre njerëzve kanë dalë dijetarë të mëdhenj si Imam Ebu Hanife e të tjerë.

Dy shtatzëni të ndryshme, dy karaktere të ndryshme

Historia e babait të Imam Ebu Hanifes është vetëm një ndër shembujt e shumtë të asaj kohe. Shembujt e mësipërm mund t'i gjejmë edhe në ditët tona. Një myslimane tregon se në shtatzëninë e saj të parë nuk kishte bërë kujdes me namazet dhe me të ngrënë dhe të pirët, ndërkohë që në të dytën kishte bërë kujdes në çdo drejtim. Nuk i linte namazet, kujdesej të lexonte çdo ditë Kur'an, largohej nga thashethemet, sillej mirë me të tjerët, etj. Ndryshimin e kuptoi pasi lindi dhe fëmija filloi të rritej. Fëmija i parë ishte më i shkujdesur, jo shumë i prirur për sa i përket pjesës fetare, ndërsa i dyti ishte i sjellshëm dhe i rregullt me namazin dhe Kur'anin, aq sa fjala e tij e parë ishte "Allah".

Historinë e mësipërme e mbështet edhe një eksperiment i bërë në Amerikë. Pranë një gruaje shtatzënë lexohet një tregim. Pas disa kohësh pas lindjes e njëjta histori i lexohet fëmijës. Fëmija e njëh dhe buzëqesh. Ndërkohë që kur i lexohet një histori tjetër nuk reagon. Shkencëtarët këtë e sqarojnë me perceptimin e botës së jashtme nga fëmija që në barkun e nënës. Prandaj, duhet theksuar edhe njëherë se kandidatet për nëna duhet të bëjnë kujdes me të ngrënë dhe të pirët dhe mënyrën e jetesës së tyre.

Kriteret se si duhet të kalohet shtatzënia janë shumë të qarta në fenë tonë. Teologët thonë se ata të cilët jetojnë brenda kornizës së caktuar nga feja nuk do të kenë probleme, sepse mirësjellja dhe edukata në Islam është të jetosh sipas urdhrave të Zotit. Dhe kjo kornizë është e përbërë nga kryerja e lutjeve, fitimi i furnizimit të lejuar (hallall), forcimi i anës shpirtërore, qëndrimi larg të ndaluarës dhe kryerja e adhurimeve të detyrueshme. Furnizimi i lejuar (hallall) ndikon në moralin e personit. Prandaj, që të kemi fëmijë të moralshëm duhet të dimë nëse ajo që çojmë në stomak është e lejuar apo e ndaluar. Ndjeshmëria e nënës ndaj namazit dhe Kur'anit gjatë kësaj periudhe, e mëson fëmijën me namaz dhe Kur'an që në barkun e saj. Gjithashtu kujdesi i saj ndaj mbulesës së saj, përveç çfarë Allahu ka lejuar të zbulohet, mundëson që fëmija në të ardhmen ta mbrojë veten nga e ndaluara (harami). Mbi të gjitha, në sajë të gjithë këtyre që përmendëm, fëmija kur është fetus është i qetë dhe lind i shëndetshëm.





أَسْتَغْفِرُكُمْ رَبِّي إِلَهُهُ هُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ
وَكَلَّمُوا عَلَى يُوسُفَ أَوَى إِلَيْهِ أَبُوهُ وَقَالَ ادْخُلُوا مَعِيَ
قَالَ اللَّهُ آمِينَ ﴿١٠﴾ وَرَفَعَ أَبُوهُ عَلَى الْعَرْشِ وَخَرُّوا لَهُ
وَقَالَ يَا أَبَتِ هَذَا تَأْوِيلُ رُؤْيَايَ مِنْ قَبْلُ قَدْ جَعَلَهَا
خَطًّا وَقَدْ آخَسَنِي إِذْ أَخْرَجْتَنِي مِنَ السِّجْنِ وَجَاءَ بِ
مِثْلِ الْقُرْآنِ مِنْ تَعْلِيمِ أَنْ تَزُجَّ الشَّيْطَانُ بَيْنِي وَبَيْنَ إِخْوَتِي

النَّحْبِ
تَكُونُ خَرَصًا
فَهُوَ كَط
وَقَالَ يَا أَسْلَى
إِنْ هَذَا
لَا تَقْلَقُوا
مِنْهُنَّ
سَمِ يَتَكَلَّمُوا
غَيْبِ نُوحٍ
رَوْ تَوَلَّى
يَسْرَ قَا

ROLI I FESË, NDIKIMET E KOHËS DHE SFIDAT E MODERNITETIT...



Koha moderne në shoqërinë shqiptare ka sjellë ndryshime të cilat janë me natyrë eruptive. Ajo me sa duket po reformat dhe transformon shumë ide, koncepte, praktika, besime dhe mënyra jetese, të cilat deri në kohën e tanishme kanë patur më shumë qëndrueshmëri tradicionale dhe rezistencë ekzistenciale. Aq të forta janë tronditjet e modernitetit në shoqërinë e sotme sa që siç duket ato kanë bërë përpjekje për të lëvizur edhe "gurët e rëndë" të fesë, peshën dhe autoritetin e veçantë të institucioneve të besimit fetar tek njerëzit tanë. Sigurisht që nuk është fjala këtu për të bërë nihilistin. Por ndërkaq nuk mund të jemi aq fundamentalistë sa të mos kuptojmë drejt dhe të interpretojmë sociologjikisht saktë atë që po ndodh në shoqërinë e sotme shqiptare me fenë si doktrinë teorike dhe ndryshimet paradigmatisht të ndikimit të saj tek besimtarët. Kjo do të thotë se kur shikojmë dhe flasim për raportet e reja të fesë dhe besimtarit të saj duhet të vlerësojmë ndikimet e modernitetit në ndryshimin e tipologjisë së marrëdhënieve në lidhjet, raportet dhe marrëdhëniet midis tyre.

Kjo ngaqë zhvillimi dhe moderniteti social në shoqërinë shqiptare, duam apo nuk duam, po ndikon në atë që sociologët e fesë e kanë quajtur si "proces rithemelimi" të fesë dhe besimit fetar. Në të njëjtën kohë dhe paralelisht me të është duke ndodhur procesi paralel i "ripërshtatjes individuale" të njeriut besimtar me fenë, pushtetin dhe autoritetin moral të saj. Padyshim jetojmë në kohë moderne, e cila favorizon dukshëm individualizmin dhe marrëdhëniet e personalizuara të njeriut me besimet fetare individuale. Pa mohuar rolin e riteve kolektive të besimit duket qartë prirja e njeriut modern që nuk i ka aq shumë qejf praktikatat kolektive dhe "bashkësitë" qoftë organike të besimit të kohës sonë apo format e sajura të ritualeve klasike të kohës së shkuar.

Njerëzit besimtarë në shoqërinë tonë kanë të drejtën e tyre që të jenë të prirur të besojnë, por ndërkaq nuk duhet të harrojmë veçoritë e reja të njeriut besimtar të kohës moderne që edhe besojnë në fenë e tyre por edhe ecin në jetë duke ndjekur imperativat e kohës dhe sfidat e shoqërisë, duke qenë në të njëjtën kohë edhe besimtar, por dhe vendosmërisht të orientuar drejt progresit dhe zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social. Ndaj nuk mund të mohojmë se të gjithë, besimtarë dhe laikë jetojmë së bashku në "kohën tonë", në kohën kur siç duket moderniteti kërkon të bëjë sunduese idenë se "E drejta shekullare dhe racionalizmi politik përbëjnë instrumente premtues për atë që kërkon

emancipim". (Buruma, Margali, "Oksidentalizmi" fq. 35)

Në sociologjinë e sotme shqiptare është e domosdoshme të bëhen analiza më të thella për raportet e fesë me veten si doktrinë që duhet t'i përgjigjet sfidave të kohës, duke ruajtur identitetin por dhe duke pranuar ndryshimin. Sepse çështjet e marrëdhënieve të njeriut besimtar me fenë e tij, lidhjet e fesë me njeriun laik janë bërë çështje me rëndësi. Natyrisht sociologjia nuk merret me përmbajtjen e dogmës fetare të asnjë feje, por ne për shumë arsye empirike dhe ndikime në jetën praktike të këtij raporti nuk mund të jemi indiferentë, të mbyllim sytë me atë fenomen që studiuesi Oliver Roy e konsideron dhe e sintetizon me konceptin e "fetarisë". Që në kohën e sotme në esencën e vet ka të bëjë me mënyrën se si e ndërton besimtari raportin individual me fenë që beson. Problemi është se zhvillimi në shoqërinë shqiptare ka sjellë pasoja jo vetëm në këto raporte të ndryshuara të fesë me veten dhe njeriut besimtar me të, por dhe të shfaqjes së një "krize" të referimit kulturor ndaj fesë.

Me gjithë qëndrueshmërinë e gjatë të doktrinafe fetare dhe militantizmin e njohur të besimtarëve ndaj saj, koha provoi se edhe feja nuk mund të shpëtonte nga andrrallat e modernitetit dhe nevoja e ridimensionimeve të duhura, për t'u përshtatur më mirë me imperativat e ndryshuara të kohës, me natyrën e modernitetit social, prirjen e marrëdhënieve individualiste dhe relacioneve të personalizuara të njeriut të sotëm. Prirje të cilat jo vetëm po bëhen të thella, por ato jo gjithnjë janë aleate dhe në favor të konsolidimit të fesë dhe besimeve fetare.

Prirja laike dhe atomizuese e shoqërisë shqiptare nuk është shumë e favorshme për trajtimet doktrinare dhe organizimet klasike holiste të fesë. Sociologët e fesë, mendimtarët modernë të saj e kanë kuptuar jo vetëm këtë prirje sunduese të zhvillimit të shoqërisë në kohën tonë, por dhe ndryshimet radikale që ka pësuar "thelbi" dhe natyra e njeriut. Natyrisht pa lëvizur gurët themeltarë të doktrinafe, në botën moderne ka filluar lëvizja për të krijuar "identitete të reja" fetare më fleksibile dhe më afër imperativave të kohës dhe natyrës së paqëndrueshme të njeriut të sotëm.

Sociologët e fesë kanë filluar të gjurmojnë këto lëvizje dinamike dhe dialektike të fesë, që janë elementë pozitivë të përpjekjeve për ta bërë fenë sa më kompatible me kohën, për t'i shërbyer më mirë paqartësive dhe dilemave shpirtërore

të njeriut të çoroditur nga "lëvizjet tektonike" të modernitetit dhe plotësimit të nevojave sociale të shoqërisë. Sidomos vakumeve dhe boshllëqeve shpirtërore të individit.

Kjo përpjekje tregon se era liberale nuk mund të lërë pa ndryshuar dhe reformuar edhe institucione të tilla sociale me natyrë të qëndrueshme dhe "konservatore", siç janë në përgjithësi ato të fesë. Kjo nuk është shenjë dobësie, por force. Sepse, pa u përshtatur me kohën, nivelin e zhvillimit social dhe precedentët e zhvillimit të përsheptuar kulturor të individit, feja do të rrudhet, do të humbasë terren social dhe autoritetin e duhur ndaj njerëzve besimtarë.

Ndryshimet që po ndodhin sot në shoqërinë tonë janë akoma apo duken timide dhe të ndrojtura. Sepse ende nuk po reflektohet sa e si duhet urgjenca e ndryshimeve dhe përshtatjeve konceptuale dhe kontekstuale të fesë, të cilat sipas mendimit tim janë ndryshime që në të ardhmen nuk do të jenë vetëm kalimtare dhe të përkohshme. Në se do të qëndrojnë kështu raporti i fesë me veten dhe relacionet e saj me besimtarët, kam frikë se nuk është e largët dita që ajo të ndjejë dhe pranojë "krizën kulturore" të doktrinëve të saj, njëherësh të shoqëruar me zgjerimin e përsheptuar të laicizimit dhe shekullarizimit, që në kohën e sotme nuk janë aq shumë aleatë të saj. As prirja moderne e shoqërisë shqiptare nuk është aq shumë favorizuese për autoritetin e fesë, në se ajo nuk bindet për nevojat e ndryshimeve konceptuale, kulturore dhe marrëdhënieve kontekstuale të saj. Ndryshimi i bazës kulturore dhe ndërtimit të marrëdhënieve mbi bazën e kohës së re, nuk është as dëmtim i autoritetit doktrinor as asimilim i trojeve të natyrshme të fesë dhe institucioneve të saj.

Feja dhe institucionet fetare janë të domosdoshme. Ato janë institucionet fundamentale dhe më potentet, që mund të ndikojnë në kohezionin e prishur social të shoqërisë shqiptare dhe përmirësimin e shpirtit të shprishur të njeriut modern nga konsumi, paraja, egoizmi, individualizmi dhe seksualiteti. Është e vërtetë që moderniteti ka favorizuar njeriun modern që është laik dhe jo rrallë pa "dimension shpirtëror". Në shoqërinë tonë po shtohen njerëzit e "zhveshur nga shpirti". Sepse siç thonë sociologët e modernitetit "Besimi i verbër te forcat e tregut e ka kthyer lakminë në një dogmë, me pasoja shpesh katastrofike".

Këto edhe të tjera arsye sociale janë ato që e detyrojnë fenë dhe institucionet e saj në shoqërinë tonë që të rishikojë pozitën dhe

efiçencën në raport me shoqërinë. Sepse jetojmë në kohë të reja kur kanë ndryshuar raportet e fesë me shoqërisë dhe të njeriut me hyjnoren. Kjo është një gjë e madhe që duhet llogaritur me të gjithë kostot e veta. Ndoshta duhet vlerësuar procesi masiv, i zgjeruar integral të cilin Maks Veberi e konsideroi si fillimin e procesit të "ç'magjepsjes së madhe" të shoqërisë. Me sa duket nuk jemi as në fillimin por as në fundin e ndikimit vendimtar të fesë në shoqëri. Por që pozitë dhe autoriteti i saj në kohën tonë ka lëvizur, kjo është e padyshimtë. Po dominojnë në mënyrë të dukshme prirjet e njeriut për më shumë marrëdhënie sociale, kulturore, politike mbi ato fetare. Këto janë kategoritë më imperative të organizmit të jetës dhe orientimit të intelektit të njeriut laik. Njeriu i kohës moderne po përpiket vetë të ecë duke besuar tek vetja, duke e marrë mbi vete përgjegjësinë laike të organizimit të tipologjisë së jetës së vet, pa patur shumë nevojë për ndërmjetësime të tjera. Kjo situatë e disfavorizon peshën dhe autoritetin e fesë në shoqërinë e sotme.

Por ndërkaq jeta e sotme në shoqërinë tonë është e mbushur me njerëz arrogantë dhe egoistë, që janë materialistë, efikas dhe të suksesshëm nga ana materiale, por që kanë mangësi shpirtërore ngaqë nuk kanë mekanizmin individual të lidhjes me fenë apo të ndërtimit të një lloji "fetarie të re", moderne por të domosdoshme. Kjo është ajo që na duhet. Madje tani dhe sa më parë që të jetë e mundur, në mënyrë që të ndalim këtë shkretim dhe degradim shpirtëror të njeriut të kohës sonë, që ta bëjnë këtë rol, nuk duhet të ngulin këmbë që njeriun modern dhe besimtar ta trajtojnë si qenie infantile, që edhe pse është besimtar nuk mund të jetë skeptik ndaj mungesës së ndryshimeve dhe një farë konservatorizmi këmbëngulës doktrinor të fesë.

Kjo është dialektika e jetës e përplasjes së prurjeve të modernitetit që e bën problematike praninë e njeriut pa dimension shpirtëror. Feja ka shumë mundësi të luajë rolin e saj në këtë betejë ekzistenciale të përplasjes së koncepteve të njeriut, të ndërtimit të mekanizmave për t'u përballuar me problemet e thella, tejet të ndërlikuara të "botës së jetës" moderne. Mbase po të punohet ndryshe, mund të mbërrijmë në synimet e mira të besimit fetar, në mënyrë që sa më shumë shpirtëror të bëhet njeriu, aq më shumë racional do të jetë. Kjo është formula, që feja të ndikojë në mundësinë që emancipimi social në shoqërinë tonë të mos çojë në zbehjen e mëtejshme të spiritualizmit.



Verësimi i diturisë SIPAS FESË ISLAME

*"A mund t'i thotë mendja se trupat qiellorë dhe toka kanë vetveten?
Kurrsesi, sepse njeriu nuk sheh asgjë në botë që të krijojë vetveten."*¹

Dituria është mjeti që të çon në krijimin e një jete të qetë e të lumtur, të mbrojtur nga pengesat e vështirësitë dhe është stolia më e bukur që hijeshon mendjen e shpirtin e njeriut. Ajo është arma më e fortë në këtë jetë tokësore dhe kapitali më i çmuar për jetën tjetër. Me diturinë të Zotit i Lartësuar fillon angazhimi hyjnor që ia dërgoi nëpërmjet engjëllit Xhibril Muhamedit a.s.. Ai i tha: "Lexo!" Përgjigja ishte: "Nuk di". Së fundi i tha: "Lexo, me emrin e Zotit tënd". Pra Allahu i Lartësuar e filloi edukimin e arsimimit, që do të thotë se Ai merret në vazhdimësi me edukatën e krijesave të Tij. Ai tregon qartazi se mëshira e Tij e pakufizuar është që të ndriçojë zemrat e njerëzve me dritën e diturisë, t'u mësojë atyre vlerën e madhe që ka shkrimi e leximi, sepse mungesa e tyre do të linte njerëzimin në errësirën e paditurisë. Por tërheq vërejtjen se dituria nuk ka fund dhe prandaj Profeti a.s. është lutur: "Zoti im, më shto mua diturinë!" Në të vërtetë, Profeti a.s. ka qenë përmbledhësi i diturive

të ardhura para tij dhe atyre që do të vijnë më pas. Dituria duhet të jetë gjithëpërfshirëse, si fetare ashtu edhe shoqërore e shkencore, që t'i shërbejë njeriut në përmirësimin e kushteve materiale e shpirtërore. Profeti a.s. ka thënë: "Kërkimi i diturisë është detyrë e domosdoshme e me rëndësi për çdo burrë dhe grua". Pra kërkimi i diturisë i përket të dy gjinive së bashku, pa asnjë dallim, por deklaroi në mënyrë shprehëse se burrat dhe gratë myslimane, përgjithësisht duhet të jenë të ditur. Zoti në Kur'an urdhëron e thotë: "Nuk janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë".

Feja islame i kushton një vëmendje të veçantë gruas, pajisjes me dituri dhe edukimit të saj të shëndoshë, sepse ajo konsiderohet si edukatorja e të gjithë njerëzimit.

Sot, edhe pse jetojmë në shekullin e shkencës dhe diturisë, teknologjisë më të avancuar, qenia njerëzore mbetet përpara sekreteve që mbart universi. Mendja e njeriut përpara fenomeneve të natyrës ka bërë hapa të

1. H. I. Dalli, Ajka e kuptimeve të Kurani Qerimit, f. 159.

rëndësishëm për t'u futur në të fshehtat e tyre. Por këto nuk janë veçse argumente që do t'i shërbejnë njeriut për të njohur Krijuesin apo Ligjvënësin e tij. Pra, duhet përdorur logjika e shëndoshë duke besuar se të gjitha të fshehtat që zbulohen janë krijuar nga Zoti i lartësuar, i Cili është i gjithëditur dhe i gjithëfuqishëm, pa fillim dhe pa fund. Një nga atributet e Allahut është dituria. Në Kur'an thuhet: "Ai është Allahu përveç të cilit nuk ka zot tjetër. Ai e di të fshehtën, edhe të dobishmen. Ai është mëshiruesi, barmirësi."¹

Si ka mundësi njeriu të jetë mosmirënjohës kur i përdor disa shkenca antifetare si teoria e Darvinit që i merr si të vërteta dhe mohon Zotin e tij? Nuk mundet në asnjë mënyrë që njeriu të zgjidhë gjithë çështjet që përjeton në natyrë nëpërmjet argumenteve shkencore. A kujton ai se është krejtësisht i përsosur? Jo, ai e ka pronarin e pazëvendësueshëm, që nuk bën ortakëri me askënd në punën e Tij. Sot shkenca është tronditur nga të vërtetat e padiskutueshme që ka sjellë Kur'ani dhe të vërtetat e tij po dalin në shesh dhe po i nxjerrin studiuesit e rinj. Në Kur'an thuhet: "Çelësat e fshehtësive janë vetëm në dorën e Tij. Fshehtësinë nuk e di tjetërkush veç Tij. Ai e di çka ka në tokë e në dete. Jashtë dijes së Tij edhe një gjethe s'mund të bjerë dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë e të thatë që s'është shënuar në librin e hapur."²

Në këtë dritë duhet të shohim shkencat e ligjet e natyrës dhe krijesat në tokë e dete. Mbi këtë bazë duhet të ndërtojmë vëzhgimin e botës së gjallë, të bëjmë eksperimente dhe të vërtetojmë se asgjë nuk krijohet në mënyrë të rastësishme, qoftë edhe instinkti i kafshëve. Krijimi i të gjitha gjallesave është projektuar me ligje të sakta si për botën bimore ashtu edhe shtazore, për të ruajtur trashëgiminë e tyre. Në këtë fushë bëhen eksperimente, por asgjë nuk krijohet pa pasur qelizën origjinale. Le të marrim iniciativën dhe të krijojmë jetë të gjallë. Janë përpjekur, por nuk e arrijnë dot. Ligjet e Allahut për krijimin e jetës së gjallë, nuk mund të eksperimentohen. Këtu kemi të bëjmë me shpirtin që nuk është lëndor dhe s'mund të eksperimentohet. Shprehja e popullit thotë për njeriun që vdes: "I doli shpirti". Pra, nuk mundet që çështjet fetare të zgjidhen me metoda shkencore, por duhet t'i nënshtrohen diturisë dhe fuqisë absolute që e solli vetë njeriun në një organizëm të përsosur, çdo organ në vendin e duhur, në harmoni me njëri-tjetrin dhe të gjithë së bashku përbëjnë unitetin apo "unin njeri". Ky mbasi i fitoi këto nuk tregohet mirënjohës, falënderues dhe adhures ndaj Tij. Njeriut iu dhurua mendja për të fituar dituri dhe me anë të kësaj është i detyruar të vërtetojë Krijuesin e vërtetë. Feja nuk është produkt i vetë njeriut, por Krijuesi për të ruajtur të pastër krijesën e Tij dërgoi mesazhe hyjnore nëpërmjet të dërguarve të Tij. Njeriun e ka shoqëruar feja që nga origjina e deri

më sot. Ai s'mund të ndryshojë rrjedhën e jetës, të kthejë pleqërinë në moshën e rinisë, apo të kthejë të vdekurit në jetë. Ku është kompetenca e shkencës? Pse shkencëtari apo mjeku nuk mbron veten e tij? Pra është feja, besimi në Zotin që i hap dritat shkencës dhe të gjithë njerëzit nën këtë moto të jetojnë të qetë e në harmoni me njëri-tjetrin.

Njeriu gjatë shekujve ka përjetuar luftëra shkatërrimtare dhe vetë ka prodhuar armët më të përsosura për të asgjësuar veten. Pra një armiqësi e tmerrshme vetëm për interesa materiale. Në këtë mënyrë shkencëtarët nuk kanë bërë përpjekje lidhur me formën e jetës së individit e shoqërisë. Për shkencëtarët nuk ka pasur as nuk ka vlera fakti që jeta jetohej kështu ose ashtu, që njerëzit të jetojnë të qetë e të lumtur. Njerëzit po sillen si ujqër ndaj njëri-tjetrit, krimet kanë arritur deri brenda familjes, gjë që tregon një ftohtësi të jashtëzakonshme. Po hidhen bomba e dinamit që nuk kursejnë as nënat e fëmijët e vegjël. Ka një kontradiktë të madhe sot brenda vetes së njeriut që është shkencëtar apo mjek. Është i njëjti njeri, nga njëra anë përpiket të shpëtojë jetë njerëzish, nga ana tjetër angazhohet për të prodhuar helme për ta mbytur atë. Me bomba të tilla kanë humbur miliona jetë njerëzish. Këtë e bën mungesa e fesë dhe e moralit fetar. Shkenca e pabazuar në miratimin e Krijuesit, Zotit të lartësuar, i sjell shkatërime në tokë njerëzimit. Për të këtë arsye Allahu i madhërishtëm mesazhin e parë hyjnor e dërgoi në urdhrin "Lexo!". Ky urdhër i është dhënë të dërguarit të Tij, Muhamedit a.s. bashkë me emrin e Tij: "Lexo, në emër të Zotit tënd!". Të mësosh dituri pa emrin e Krijuesit, do të thotë të mos e njohësh Atë. Atëherë prit ndëshkimin e tij. Prandaj Allahu i lartësuar u drejtohet mirënjohësve dhe atyre që u besojnë shkencave e u thotë: "Thuaj: "Sikur Allahu të na zgjaste natën deri në kiamet, cili zot tjetër do të mund të na sillte dritë? A nuk e kuptoni? Thuaj: "Sikur Allahu të na zgjaste ditën deri në kiamet, cili zot tjetër do të mund të na sillte natën që të çlodheshit? Akoma nuk doni të shihni të vërtetën.""

Njeriu me logjikë e arsye duhet t'i thërrasë ndërgjegjes së tij, të besojë Zotin e lartësuar, sepse këtu, në këtë botë, nuk mbaron çdo gjë për të. Kjo është botë provizore e tranzitore për të kaluar në botën tjetër në të cilën njeriu do të përgjigjet përpara Krijuesit për veprimtarinë e tij. Do të jetë përballë gjykatësit, fuqia e të Cilit është e pashembullt, që çdo send e ka krijuar nga hiçi apo asgjëja, e bëri të mirëqenë për njeriun, që është krijesa më e lartë dhe sundues në këtë botë me dijen e tij. Por pa dyshim, ka krijuar edhe një botë tjetër, të amshuar, të cilën mendja e njeriut nuk arrin ta konceptojë, por logjika e tij duhet ta provojë se ai vend nuk ka mbarim dhe këtu do të përjetojë shpërblimin ose dënimin për veprat e kryera. Prandaj secili duhet të kthehet me vetëdije në Islam e të dëshmojë: "S'ka zot tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Tij".

1. Hashr, 22.

2. En'am, 59.

KURBAN BAJRAMI

është festa që simbolizon dashurinë





Të dashur besimtarë, motra dhe vëllezër shqiptarë!

Sot në vendin tonë dhe mbarë globin ka festë, ka bajram. Kurban Bajrami është festa që simbolizon dashurinë dhe përkushtimin e robit të devotshëm ndaj Zotit të gjithësisë. Zoti në Kur'an thotë: "Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre (kurbanëve), por tek Ai arrin devotshmëria e juaj..." ky ajet kuranor reflekton esencën dhe domethënien e kësaj dite.

Kjo ditë është dita që na kujton se duhet të jemi të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve. Kjo është dita për të kuptuar se vlera dhe dinjiteti njerëzor janë shumë të çmuara dhe ndaj tyre duhet kushtuar vëmendje e lartë. "Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe mjerë për atë, që e përçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Allahut", -ka thënë profeti Muhamed (a.s).

Zbutni zemrat me njëri-tjetrin. Largohuni nga veset. Ruani veten nga ligësitë dhe padrejtësitë.

Mos u bëni lakmitarë ndaj njëri-tjetrit. Motra dhe vëllezër! Kjo botë nuk do t'i mbetet askujt!

Kthimi ynë do të jetë një ditë te Zoti, kjo është e pa diskutueshme. Andaj punoni për këtë Ditë!

Motra dhe vëllezër!

Familja është qeliza bazë e shoqërisë. Zoti krijoi Ademin dhe Havanë, e prej tyre u formua familja dhe u trashëguua gjinia njerëzore. Ky është një ligj i pandryshueshëm deri në fund të kësaj bote. Edukojini fëmijët me moral të pastër investoni që ata të pajisen me dije të gjithëanshme fetare, sociale e shkencore.

Ktheni vëmendjen nga prindërit, të sëmurët, të varfërit, tregoni dhembshuri ndaj tyre.

Kam një apel për rininë: Pajisuni me moral të bukur, kthejini sytë nga Zoti, rrini larg tundimeve të kota. Mos ikni nga vendi, projektojeni të ardhmen këtu, në vendin tuaj. Koha dhe rrethanat në të cilat jetojmë kanë bërë që shumë njerëz të orientohen drejt individualizmit. T'i shpëtojmë këtij kurthi të kohës! Të bëhemi altruistë, besimtari duhet të jetë i tillë. Të mos

humbasim vlerat e larta të humanitetit. Të sakrifikojmë nga e mira individuale për të mirën e përbashkët.

Mos harroni se mëshira është një ndër bazat e Islamit. Drejtësia është një nga shtyllat bazë të mirëqenies dhe paqes sociale në një shoqëri. Profeti ynë i dashur ishte ai i pari që dëshmoi gatishmëri dhe tha fjalët historike në lidhje me respektimin e drejtësisë: "Sikur edhe e bija ime, Fatmija, të kishte vjedhur, do ta kisha dënuar dhe do ta kisha çuar në vend drejtësinë."

Këtë parim duhet ta ketë në mendjen e tij çdo njeri që ka pushtet në dorë, por jo vetëm, ky është parim mbi të cilin duhet të ndërtojë jetën e tij çdo besimtar.

Kur'ani dhe jeta e profetit (a.s.) janë udhërrëfyesi ynë.

Edhe në Kuran për drejtësinë dëshmohet kështu: "O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmeve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai, Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas dëshirave tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroni dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që Allahu e di se çfarë bëni ju". (Nisa, 135)

Të dashur motra dhe vëllezër!

Në vendet e shenjta, sot, ndodhen mbi pesëqind shqiptarë, e miliona të tjerë nga mbarë bota për Haxh. Le t'i lutemi Zotit që të kthehen shëndoshë e mirë dhe me haxh të pranuar. Pas namazit le të shpërndahemi nëpër shtëpitë tona, të bëjmë bajram me familjet tona; të bëjë kurban, kush ka mundësi, dhe të gëzojmë fëmijët. I lutem Zotit të na pranojë adhurimet tona.

Ju dëshiroj të gjithëve një Bajram të begatë. Zoti e bekoftë vendin tonë dhe botën mbarë me paqe, harmoni e prosperitet.

Gëzuar!

Fjalimi i kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me rastin e festimit të Kurban Bajramit.

Sakrifica e

Kurban Bajramit

"Ibrahimi nuk ishte as Çifut as i Krishten, por ishte njeri i drejtë, Musliman i sinqertë, dhe se nuk ishte nga idhujtarët.

"Padyshim, populli më i afërt ke Ibrahimi janë ata që e ndoqën atë dhe këtë Profet si dhe ata që besojnë (atë), dhe se Zoti asht mbrojtësi i besimtarvet" (3:66,67).

Madhnija qoftë e Zotit, që ia mbrritëm të festojmë këtë ditë sakrifice. Kjo asht festa zyrtare ma e madhe e Islamit, mbasi në këtë kohë kryehet vizita vjetore (Haxh-xhi) e botës Myslimane në Meqqe.

Me të vërtetë asht një gëzim shpirtnuer i pa tregueshëm për besimtarët kur kujtojnë se, gjatë kësaj kohe, në qytetin e shenjt të Meqqes asht mbledhun lidhja shpirtnore e kombeve të botës Islame. Na mund të përfytyrojmë vargun e pakëputun të mijra njerzve me kombësi të ndryshme t'i përgjigjen Nji zani Shpirtnuer me anën e shprehjes së një formule-besimi e, çka ma tepër, të tanë janë veshun me një lloj robe të bardhë.

Sikurse e dini kjo shtyllë e madhe dhe ceremoni e përbotshme bahet në përkujtim të hapit marrun nga Ibrahimi (a.s.) për të therrë birin e vet, Ismailin, (ndërsa i biri i dytë, Is'haku, ende s'kishte lindun). Ibrahimi pa në andër se qe tue therrun birin e vetëm. Ai, tue kujtue se kjo ishte dëshira e Zotit, ndërmorri t'a zbatojë në fakt. Ai kujtoj se, ndoshta në dijenin e Zotit, dashtunija e tij për Ismailin ishte një pengesë kundrejt detyravet të veta Hyjnore. Çfarë do që të ketë qenë interpretimi i andrrës së tij mbi këtë çashtje, ai mendoi se kjo ishte Dëshira e Tij. Kur Ibrahimi u ba gati të therrte djaln e vet Zoti i tha se, sprovimi i tij ishte krye ndërsa qëllimi i vërtetë nuk ishte ai. Fakti asht se sakrifica e pamun në andërr ishte për një realizim shumë ma të naltë se sa therrja e thjeshtë me thikë. Asht plot kuptim që ngjarja e sakrificës, me gjithse e shkrueme në traditat Izraelite, asht përkujtue vetëm nga Ismailitët dhe vllazënve shpirtnorë të këtij, Muslimanët.

Haxhereja ishte një nga princeshat egjiptiane, marrun skllav lufte kur ajo ra në dorë të Sarës, në shtëpi

t'Ibrahimit. Ngushëllimi i vetëm i saj ndoshta, ishte që qëllloi t'i shërbejë një grueje të Profetit. Ma vonë, kur Sarea ia dha Ibrahimit si grue ligjore dhe ashtu sikur dëshironte Sarea, lindi një djalë, trashëgimtar i Ibrahimit, Haxherea kujtoi se me t'u ba një mëmë kryenaltë në një familje të madhe profetike, ditët e mizerjes së saj kishin kalue. Mirë po fati vendosi ndryshe. Ajo dhe i biri, trashëgimtar i të shoqit, duhesh të jetonin të braktisun, largë nga vend-banimi i Profetit dhe nga fushat e aktivitetit. Por, tue qenë shërbëtorë të divotshëm të Zotit, kurrë s'mund t'i zmbapste nga bindja e vullnetit të Tij. Ibrahim me urdhën Hyjnuer, mori gruen e djalë dhe i çoi në një vend të largët, rrethue prej shkretinash të mëdha. Vendi i caktuem ishte qyteti i Meqqes, ku gjindesh Qabeja, Faltorja ma e vjetër e adhurimit Monotheist. Mbas kësaj, tue përjashtue vizitat e rastësishme t'Ibrahimit, amë e bir ishin lanë nën kujdesin e Zotit.

Ismaili u martue e, mbas vdekjes së tij, pasardhësit që la mbrapa, u shumuen bres pas brezi, mirë po ishin këputun nga tradita e përgjithshme e racës çifute sikur e vazhduen Izraelitët atë t'Ibrahimit. Asnjë vepër e shqueme nuk ishte shinue, për shumë shekuj, nga pasardhësit e Ismailit. U duk që vizioni i Ibrahimit si dhe vizioni i sakrificës nuk patën dhanë asnjë frut të dukshëm dhe se braktisja e Islamit ishte një refuzim. Por ligjet e Zotit janë çuditërisht të mëshefta! Ismaili dhe pasardhësit e tij ishin braktisun, flakun dhe harue nga dega tjetër e familjes. Kështu, kjo e fundit, refuzoi Profetin Muhammed dhe parakaluesi i këtij filloi t'adhurohet si Zot nga një pjesë e njerzimit. Po, Muhammedi ishte një trashëgimtar i Ismailit të harruem që rivendosi traditën e adhurimit Monotheist e që i dha një gjallëri e përgjithësi si mbas kohës.

Gjendja e mjerume e Qabes, në kohën e lindjes së Muhammedit (a.s.), dhe ringrefja e saj, në kuptimin shpirtnor, ishte rikthimi i saj për me shërbye si qendër e re dhe e fuqishme e botës mbarë për përhapjen e Monotheizmit. Po ashtu, vënja përsëri e gurit të zi, pjesa e mbetur e ndërtesës së ngrefun nga një kohë që s'mbahet mend, ishte, si duket, një referencë simbolike për ardhjen e famëshme të Profetit t'Ismailit Muhammedi. Guri i zi i Qabes, me gjithse një copë gur, për Muslimanët ka ma tepër se një kuptim dhe vlen ma tepër se monumentet e tjera. Padyshim, simbolikisht ai qëndron si piramida ma e madhe në Historinë e Shenjtë të racës s'onë.

Pra, në celebrimin e aniversarit (përvjetorit) të sakrificës s'Ibrahimit, na Muslimanët rivërtetojmë pretendimet t'ona të traditës së Ibrahimit me anë t'Udhëheqësit t'onë Profetit të Shenjt, Muhammedi, i cili asht pasardhës i asaj Patriarke nëpërmjet Ismailit.

Verseti i parë shkruar në fillim të këtij artikulli thotë se, feja e Ibrahimit, nëse gjindet ndokund gjetkë, ndodhet në Kuran dhe se Ibrahim s'ka qenë as çifut

as i krishten, por njeri i drejtë, d.m.th. Musliman. Mund të thotë ndokush që si asht e mundun për Ibrahim të jetë Musliman?

Për fat të keq, gati në të gjithë botën jo Muslimane, fjalët "Islam" dhe "Musliman" janë kqyrun si emna të një llojshëm me ato fetaro-shoqnore të botës.

Mirëpo kjo i detyrohet injorancës së tyre për sa i përket kufizimit që ata u bajnë fjalëve Islam dhe Muslim. Si mbas Kuranit Islami asht aqë i vjetër sa njerzimi vetë. Profeti Muhammed ishte Musliman, e kështu ishin të tanë udhëheqsat shpirtnorë, të cilët patën realizue Zotin me an t'Islamit. Kështu jo vetëm Ibrahim, por gjith profetnit dhe ringjallësat e fesë ishin Muslimanë.

Veç asaj ka edhe një qëllim tjetër në cilësimin që i ban Kurani Ibrahimit si Musliman. E kam përmendun këtë ma nalt kur fola mbi cilësimin e përbashkët të të gjitha feve. Vizioni i përgjithshëm i tyre asht, pak a shumë i ngushtë, mbasi çdo pikpamje e pjesëshme asht mohimi i pikpamjes fetare. Në të vërtetë, në përpjekjet për t'a përgjithsue fenë, ska qëllim tjetër veçse për t'a përgjithsue Zotin. Idea për një popull të zgjedhun, me përjashtimin e dukshëm t'Islamit, gjindet gjithkund në fenat e tjera.

Tash, kur njeri realizon Zotin, lypset t'a realizojë në përgjithësi, e kur ky realizim vjen, duhet të zgjanojë shpirtin dhe vetëdijen e përgjithshme. Prandaj shpirtinat që kanë kuptue Zotin janë përmbi gjithë komunitetet. Në këtë kuptim, kishte me qenë gabim me u thirrë Profetët çifutë. Këta shpirtna të mëdhenj, padyshim, krijuen komunitetet e tyre përkatëse, por, për sa ka të bajë mesazhi dhe revelata e tyre, ngel e pandryshme. Lidhjet e tyre janë krejt shpirtnore dhe se vizioni asht i përgjithshëm, i detyrohet këtij fakti që i asht ba referenca në fjalë, "populli ma i afërt ke Ibrahim janë ata që ndjekin gjurmat e atij dhe të këtij Profeti si dhe t'atyne që besuen në të". Me fjalë ishin të vërtetë në vizionin e tij shpirtnor. Të gjithë ata që kanë ardhun mbas tij (profetnit e tjerë si dhe ai i Islamit, Muhammedi, i cili mbas kaqë kohë të kalueme, ringjalli traditën e tij të një Zoti të përgjithshëm), ende ndjekin komunitetin shpirtnor t'Ibrahimit, i dallueshëm pak a shumë nga komunitetet e tjera raciale. Tue përkujtue emrin e Ibrahimit, me anë të kësaj ceremonie, na jemi tue mbajtur praktikisht theorinë e fesë së tij ashtu si asht përshkrue në Kuran. Dhe çka asht ajo theori? Ajo asht se feja nuk mund të bahet fisnore ose pjesore. Në se thirrja vjen nga Zoti, rrethi i saj duhet të përmbledhë krejt njerzinë.

Asht lehtë me fol mbi thirrjen e Zotit e të fesë. Fare pak popuj realizojnë se ç'kuptim i saktë ka me iu përgjegjë një zani të tillë. A do të thotë mbytja e tanë interesave dhe shtytjeve, që depërtojnë jetën t'onë tokësore? Atë çka bajnë populli fetar asht me efektue një kompromis në mes të thirrjes së Zotit dhe asaj të

botës; dhe ky, në themel, asht gjithë turbullimi, nga i cili njerzimi asht tue vujtë. Na e shofim, në thelbin e zemrës s'onë se çka asht thirrja e Zotit në një gjendje të veçantë. Po, na gjithashtu, besojmë edhe n'eksperiencat, por harrojmë, në të vërtetë, se asht një mosbesim në Plot fuqishmenin e vullnetit të Zotit. Nga ky mosbesim i parimit moral të përgjithshëm të njerëzimit ka ardhun mbi tokë gjendja e piklueshme. Askush nuk mund t'a mohojë se për tash feja, përgjithsisht asht vetëm një lojë ose vegël në duert e interesave të kësaj bote.

Feja në vend që me naltësue deri në kulm mendjen njerzore, prej ku t'i përgjigjet thirrjes së Zotit, bahet fushë shfrytzimi i sentimenteve të një populli ose race, e në mos tjetër edhe lumtënisë ekonomike të një pjese.

Përkujtimi i Ibrahimit a nuk lypset të na çojë neve ke një vështrim ma i naltë i jetës fetare? Ke Ibrahim dashtunija e së vërtetësishte mbi të gjithë tjerat, kështu ai braktisi shtëpinë sikur pasardhësi i tij i meritueshëm Muhammedi (a.s.) për me gjetë një vend ma të mirë të përshtatshëm. Si një fakt i pamohueshëm në se një fetar predikon të vërtetën absolute me vendim të premë, ai asht i detyruem të humbë simpathinë e popullit. E vërteta e pandryshueshme predikue me seriozitet, kambëngulje, ka pasë fitue në të gjithë kohët e popujt një përbuzje të përgjithshme ibrahimi e provoi këtë pikërisht, ashtu i patën shijue edhe pasardhësit e tij, Profetët H. Isaj e Muhammedi (a.s.).

Për me u ba i zoti me thirr popullin në fen, njeriu duhet të pajiset me cilësit e nalta shpirtnore, të shvishet nga gjithë konsiderimet e natyrës toksore. Ai lypset të krijojë një trajtë mendore si atë t'Ibrahimit e cila mund t'a bajë t'afte, jo vetëm të sakrifikojë gjithë interesat ekonomike, dashamirësinë e respektin e popullit të tij, por gjithashtu, në se asht e nevojshme i fikë edhe sentimentet ma të thella personale. Jeta e Ibrahimit, padyshim, përmban një shenjë drite të qartë për udhëqsit fetarë të sotshëm që besojnë me gjysmë zemre.

Populli sot asht hutue dhe nuk e kupton dot pozitën dhe funksionin e fesë. Disa men dojnë se kjo po nxjerr njeriun nga jeta normale, dhe se po e çon kundra përparimit material. Të tjerë mendojnë se ajo s'ka të bajë me jetën e kësaj bote ose na përgatit vetëm për një ekzistencë t'ardhëshme, e cila s'ka të bajë me jetën t'onë të përbashkët këtu. E vërteta asht se feja gjindet e rranjosun në natyrën qytetnuese të njeriut. Feja, jo që nuk pengon përparimin material, por përkundrazi asht vetë fryma e jetës së një përparimi kësodore. Cilësija dalluese e fesë asht kur kjo merr parasysh krejt interesat e ekzistencës kësodore, tue nxitur ato ma të gjana e të hapuna, në të cilat shtrihet përmbushja e fundit e krejt interesave të tjerë. Kjo e vërtetë e naltë asht shprehun në Kuran kur flet mbi Ibrahimin sa vijon:

"Kur Zoti i tha atij, përulu, ai u përgjigj: Unë i përulëm Zotit të botnavet".

Po, Ibrahimiu iu përul vetëm Zotit të botnavet, d.mth. ligjit ma të naltë të jetës, të cilit, krejt ligjet e tjera i bindin. Feja duhet të qëndrojë, dhe në formën e saj të thjeshtë gjithmonë ka qëndrue, për këtë ligjë të jetës, pasqyra e së cilës na paraqitet ke Ibrahim, shembulli i vërtetë i qëllimit të fesë.

Islamizmi, feja e Kuranit dhe Muhamedit (a.s.), tue iu referue Ibrahimit si shembulli i jetës së vërtetë, themelon pozitën e përbashkët të fesë. Po, gjithashtu ajo kujdesohet mirë për me s'kjarue pikpamjen e çashtjes. Ajo i ep randësi drejtësisë së Providencës Hyjnore. Zoti i Islamit asht kryesisht Zoti i virtytit, i shpirtit të kulturës dhe i shërbimit të njerzisë. Ky princip përshkruhet me fjalët si vijon:

"Kur Zoti e sprovoi Ibrahimin me disa fjalë, të cilat ai i përmbushi tha: sigurisht do të baj ty udhëheqsi i njerëzimit. "Ibrahimi u përgjigj: "Edhe nga brezi i ardhshëm i emi? Premtimi i Jem nuk përmbledh të padrejtët, tha Zoti (2:124). Ky qe një paralajmërim vërtet serioz, jo vetëm për sektet e tjera të pas'ardhshvet t'Ibrahimit, por gjithashtu edhe për vetë Muslimanët. Me humbjen e udhëheqjes së tyne politike e intelektuale në botë, ata kanë ruajtun e pohue këtë parim të Kuranit. Kombet udhëheqsa të botës le të marrin mësim nga kjo dhe nga bisedimet e tjera të Zotit me Ibrahimin, dhanun në Kuran me fjalët që posht-vijojnë:

"Dhe kur Ibrahim tha: O Zot, bajë atë (Meqqen) një qytet të siguruem dhe mbushe popullatën e tij me fruta, të tillëve nga ata që besojnë në Zotin dhe në ditën e mbrapme. Ai tha, edhe gjithkujt që nuk beson do t'i dhuroj argëtime për një kohë të shkurtë, e pastaj do t'i tërheq kah dënimi me zjarrm, po ky asht një destinim i keq". (2:126)

Tash gjithë këto mësim, që kanë të bajnë me mirëqenien t'onë shpirtnore e kulture, janë shembull i Ibrahimit që na ban me forcë të njohim, gjithashtu, një thirrje në vullnetin e mirë të mbarë njerzimit në këtë festë Muslimane të sakrificës. Asht, vërtet, një festim, me të cilin, degat e tjera ma të vjetra të paslindësve shpirtnorë t'Ibrahimit, mund të marrin pjesë me lehtësi dhe kryenaltësi.

Kurani ka lanë çelë shumë rrugë për bashkëpunim në mes të feve, për ribashkim efektiv e të vërtetë në mes të tri degëve të pasardhësve shpirtnorë t'Ibrahimit. Na Muslimanët mundemi fare lehtë t'a bajmë atë një shkak për afrim grishjeje të përbashkët fetare, për të mirën e përgjithshme të njerzimit. Tue dhanë një zbërthim të drejtë, ky mësim mjafton të shërbejë vështirsinë e vjetër shekullore në mes të tri feve të mëdha në botë. Dashtë Zoti që kjo andër të gjejë realizimin e saj të shpresueshëm.

**Marrë me shkurtime nga revista "Kultura Islame",
Nr. 4 (52), Dhjetor 1943**





BAJRAM HAXHIU
(1877-1972)

**FIGURË EMBLEMATIKE E ÇËSHTJES
KOMBËTARE SHQIPTARE**

Familja Haxhiu është një familje autoktone, intelektuale, fisnike, patriotike, atdhetare, arsimdashëse e sportdashëse e qytetit të Lushnjës. Bajram Haxhiu ose Xha Bami, ashtu siç njihet nga të gjithë lushnjarët, lindi më 3 maj 1877 në Lushnjë. Shkollën fillore dhe të mesme ai i përfundoi në gjuhën turke, në Lushnjë, kurse të lartën për financë, në Kolegj, në Stamboll, ku u njoh me patriotët e mëdhenj të kombit shqiptar. Idetë e tyre atdhetare bënë që Bajram Haxhiu gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij patriotike t'ia kushtonte atdheut dhe çështjes kombëtare shqiptare. Ai është një nga organizatorët e lëvizjeve antiosmane në Lushnjë në fillim të shekullit XX. Mori pjesë aktive në demonstratën e majit 1906 në qytetin e Lushnjës. Për këtë ai u arrestua dhe u dënua nga qeveria osmane. Pas daljes nga burgu, Bajrami nuk u ndal, por vazhdoi të merrte pjesë përsëri në lëvizjen antiosmane. Në këtë periudhë ai bashkëpunoi me çetat kryengritëse të Myzeqesë për organizimin e kryengritjes së përgjithshme të Shqipërisë. Më 1912 ai u bë përkrahës i qeverisë së Ismail Qemalit, duke luftuar kundërshtarët e saj serbë dhe kuislingët e Esat Pashë Toptanit.

Bajram Haxhiu nuk u pajtua me pushtimin e Shqipërisë nga ushtritë ndërluftuese të Luftës së Parë Botërore. Kur u pushtua qyteti i Lushnjës, ai u ngrit me armë kundër austro-hungarezëve, të cilët nisën të ndërtonin hekurudhën "Dekovil", që kalonte përmes qytetit me stacion në qendër të Lushnjës. Për këtë qëndrim të tijin, pushtuesit austro-hungarezë morën masa të ashpra ndaj tij. E internuan në Shkodër, ku kishte rezidencën komanda e përgjithshme e kësaj ushtrie, për ta pasur më mirë nën mbikëqyrje. Pas Luftës së Parë Botërore, Bajram Haxhiu u kthye në vendlindje, ku nuk e ndali veprimtarinë e tij patriotike kundër vendimeve antishqiptare të Konferencës së Parisit për copëtimin e Shqipërisë në favor të vendeve fqinje. Kjo situatë e re politike shtroi para shqiptarëve detyrën e ruajtjes së Pavarësisë, e cila ishte tronditur shumë nga shtetet ndërluftuese të Luftës së Parë Botërore, si dhe nga qëndrimi i shteteve fqinje. Për këtë duhej që shqiptarët të ruanin me çdo kusht tokat e territorit të Shqipërisë dhe prandaj patriotët kërkuan mbledhjen e një kongresi kombëtar shqiptar, që t'u bënte thirrje shqiptarëve që të ngriheshin në këmbë dhe ta mbronin me gjak atdheun. Mbledhjen e kongresit e morën përsipër patriotët lushnjarë, duke filluar nga organizimi, sigurimi i qetësisë gjatë mbledhjes, garantimi i kushteve të delegatëve, si dhe organizimi i forcave vullnetare të mbrojtjes

deri në përfundimin e plotë me sukses të tij. Një nga anëtarët e komisionit nismëtar të thirrjes së Kongresit të Lushnjës ishte Bajram Haxhiu. Ai pati një detyrë tepër të rëndësishme në letërkëmbimin midis Aqif Pashë Elbasanit dhe personaliteteve të tjera pjesëmarrëse. Bajrami u vu në shërbim të qeverisë që nxori kongresi dhe e përkrahu atë gjatë gjithë kohës që ajo i qëndroi besnike vendimeve të Kongresit. Ai përkrahu gjithashtu Luftën e Vlorës më 1920 për përzënien e forcave pushtuese italiane nga Shqipëria. Në prill të vitit 1922 ishte anëtar në komisionin për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Lushnjë.

Bajram Haxhiu ishte një besimtar mysliman i devotshëm dhe në vitet '30 ka qenë një nga kontribuuesit financiarë për ndërtimin e xhamisë së re të qytetit. Pushtimin e Shqipërisë nga fashistët italianë në prill të 1939 dhe pushtimin nga nazistët gjermanë në shtator të vitit 1943 atdhetari Bajram Haxhiu i priti me urrejtje. Ai mori pjesë gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri përgjatë viteve 1939-1944 në Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare, gjithashtu i gjithë fisi i Haxhillarëve e përkrahu luftën kundër pushtuesve deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë më 29 nëntor 1944.

Ai luftoi për një Shqipëri të lirë e demokratike dhe jo për mbylljen e vendit siç ndodhi me instalimin e regjimit diktatorial komunist në vend, të cilin e kundërshtoi që në fillim e gjer sa jetoi. Kjo gjë bëri që një nga pronarët më të mëdhenj të qytetit të Lushnjës siç ishte Bajram Haxhiu, më 9 maj të vitit 1967, të shpronësohej krejtësisht pa asnjë pagesë dhe të shpallej "kulak", i dyti në Lushnjë.

Atdhetari Bajram Haxhiu u nda nga jeta më 11 gusht 1972 në moshën 95 vjeçare, duke u lënë në harresë nga regjimi i kohës dhe pa u vlerësuar për idetë dhe veprimtarinë e tij patriotike në shërbim të atdheut.

Me rastin e 75 vjetorit të Kongresit të Lushnjës, Bajram Haxhiut iu akordua (pas vdekjes) titulli "Naim Frashëri" i Klasit të Parë nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Prof. dr. Sali Berisha, me këtë motivacion: "Është shquar për veprimtari patriotike në organizimin dhe mbrojtjen e punimeve të Kongresit Kombëtar të Lushnjës".

Për nder të patriotit të shquar shqiptar rruga pranë shtëpisë muze Kongresi i Lushnjës dhe që vazhdon drejt qendrës së qytetit mban emrin e tij. Bajram Haxhiu është babai i dëshmorit të sportit shqiptar, legjendës Abdurrahman Roza Haxhiu dhe veprimtarit të shquar për çështjen kombëtare shqiptare,

**EDUKIMI I FËMIJËS ME
EMRAT E BUKUR TË**

Zotit

Edukimi i mirë është një nga të drejtat më të rëndësishme të fëmijëve mbi familjen e tyre. Nuk ka gjë më të mire dhe më të bukur që mund të japin prindërit për fëmijët sesa edukata e mirë. Prandaj edukimi fetar që në moshë të vogël luan një rol shumë të rëndësishëm dhe thelbësor në formimin e individit. Edukimi i fëmijëve tanë bazuar në emrat e bukur të Allahut (xh.sh.) është një metodë e vlefshme dhe frytdhënëse.

Cili është vendi i edukimit fetar në edukimin e fëmijës?

Kur flasim për edukimin e njeriut edukimi fetar është një pjesë e pandarë e tij pa të cilën nuk mund ta mendojmë njeriun. Kërkimet e bëra në fushën e psikologjisë fëminore tregojnë se moshë 4 vjeç është një moshë e artë ku fëmija shfaq interesin më të lartë ndaj Krijuesit dhe besimit në Zot. Nëse tregoheni të vëmendshëm do të shikoni një shtim të pyetjeve të natyrës 'Nga kam ardhur?', 'Si kam lindur?', pyetje të cilat përfshijnë kuriozitetin e pafund ndaj ekzistencës dhe Krijuesit. Në këtë pikë duhet të plotësohet nevoja e fëmijës për njohjen e Krijuesit. Dashuria ndaj Krijuesit konsiderohet si hapi i parë i edukimit fetar të fëmijës. Edukata fetare përfshin gjithë ekzistencën e qenien e njeriut. Analizon kuptimin e jetës së tij në këtë botë dhe arsyen e krijimit. Fëmija arrin të gjejë përgjigje për të gjitha pyetjet në lidhje me qenien e tij. Me anë të përgjigjeve të marra gjatë periudhës parashkollore ai arrin në disiplinojë dhe rregullojë jetën e tij në të ardhmen.

Cfarë përfiton fëmija nga besimi në Zot ?

Besimi në një Zot përgatit një terren të përshtatshëm ku shfaqen ndjenja fisnike dhe të pastra si sakrifica, dhurimi, dashuria pa kushte. Besimi në ekzistencën e Zotit i dhuron atij ndjesinë e prezencës së një Krijuesi i cili e sheh, dëgjon dhe është me të në çdo moment. Prandaj fëmija ndihet më i sigurtë. Një fëmijë i beson më shumë nënës dhe babait të tij, besimi në Zot ja zgjeron fushën e tij të besimit e sigurisë. Ndjesia e të qenurit nën mbrojtjen e një force të mbinatyrshme, një force e cila është e gatshme ta dëgjojë e shohë në çdo moment do të krijojë një individ të sigurtë në vetvete dhe të shëndoshë emocionalisht. Fëmija i pasigurtë në vetvete do të ndihet i pavendosur dhe i lëkundur përse i përket zbulimit dhe analizimit të vetes. Në këtë rast fëmija mund të ketë probleme në lidhje me dashurinë ndaj jetës dhe do të kërkojë përgjigje në këndvështrime të ndryshme jofetare por nuk do të ndihet i plotë me përgjigjet e marra. Shpeshherë dëgjoj këta fjalë nga të rriturit 'nuk arrij të mbush boshllëkun e brendshëm' dhe ky boshllëk është pikërisht problemi i mësipërm. Individët të cilët nuk njihen me Krijuesin dhe me besimin në Zot që në fëmijëri me kalimin e kohës shprehen në lidhje me

një boshllëk të papërshtueshëm dhe të pazgjidhur. Një edukim i mire fetar sjell me vete dhe besimin në Zot dhe si rrjedhojë do t'i dhurojë fëmijës zakone të shëndetshme.

Cilat janë zakonet e shëndetshme ?

Një nga rregullat e arta të edukimit të një fëmije është fitimi i zakoneve të shëndetshme dhe dhënia e një edukate të mië. Megjithatë ky mund të duket një mision shumë i vështirë, ai mund të lehtësohet nëse shoqërohet me ndjenjën e kuriozitetit dhe emocioneve. Sipas Gazalit fëmijës duhet t'i mësojmë 'të menduarin'. Nëse fëmija meson të mendojë dhe të logjikojë para se të bëjë diçka në të ardhmen do të jetë më i aftë të marrë vendime të drejta. Siç e dimë në shumë ajete kuranore përdoret pyetja e formës 'a nuk mendoni?'. Një njeri i cili me kalimin e kohës arrin të fitojë aftësinë e të menduarit, meditimit do ta ndryshojë jetën e tij në mënyrë pozitive. Për mendimin tim gjëja më e rëndësishme që mund t'i mësohet fëmijës me kalimin e kohës është menaxhimi i kohës. Fëmija që di ta menaxhojë kohën arrin të planifikojë gjërat drejt dhe në kohën e duhur. Menaxhimi i drejtë i kohës i sjell atij suksesin në shkollë e më pas në profesion. Në pjesën e fitimit të zakoneve të mira prindërit duhet t'i japin përparësi ushqimit, gjumit pastërtisë dhe rregullave të sjelljes. Fëmijët që disiplinohen mirë në këta fusha e kanë më të lehtë të fitojnë zakonet fetare dhe adhurimet. Për shembull, një fëmijë i cili është mësuar të lajë fytyrën dhe duart çdo mëngjes e ka më të lehtë të marrë abdes. Një fëmijë i disiplinuar me gjumin e shëndetshëm do ta ketë më të lehtë zgjimin për namazin e sabahut. Mos të harrojmë dhe çështjen e pastërtisë që është një nga më të rëndësishmet.

Si është edukimi me anë të emrave të bukur të Zotit?

Sigurisht që edukimi i fëmijës nuk është i fokusuar vetëm në një rrugë apo drejtim. Dhe këtu dua të theksoj se fëmijët nuk është e thënë të edukohen vetëm me anë të emrave të bukur të Krijuesit. Ka shumë rrugë të larmishme edukimi duke filluar që nga metodat e profetit tone të nderuar të cilat mësojnë kushtet e besimit dhe të islamit. Por edukimi me anë të emrave të bukur të Zotit është më i miri. Mund t'i zbukurojmë sjelljet e fëmijëve tanë me anë të kuptimit të emrave të Krijuesit. Sigurisht që ka edhe emra të tjerë me anë të cilëve mund të kufizojmë sjelljet e papëlqyera. Mund të rrisim fëmijë të mbushur me dashuri me anë të emrit 'el /Vedud', fëmijë më të qetë me anë të ' -Halim', më falës me anë të emrit 'Gafur', më të besueshëm e të sigurtë me anë të emrit 'Mumin', më të dashur dhe bujarë me anë të emrit 'Ganij', më të ditur e kureshtarë me emrin 'Alim'. Dhe në fund them se mund të jemi nëna më të durueshme e tolerante me anë të emrit 'Sabur'.

Fajja dhe Apoptoza

Ne lindim me trupa fizikë, jetojmë në këta trupa dhe përfundimisht, i japim lamtumirën kësaj bote, duke i lënë trupat tanë pas. Trupat tanë na janë besuar dhe ne duhet të dimë se si t'i mbrojmë këto amanete, si dhe pasojat, si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën, të shkeljes së këtij besimi. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj detyre është të kujdesemi për mirëqenien tonë fizike dhe shpirtërore.

Anatomia fizike e një personi ndërvepron me anatominë e tij/saj shpirtërore. Çdo defekt, sëmundje ose shqetësim në njërin prej tyre do të ndikojë tek tjetra. Në një nga thëniet e tij të famshme, Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, vë në dukje këtë ndërveprim me theksin në zemrën si qendrën e përbërjes sonë fizike dhe shpirtërore: "Kujdes, në trup ka një copë mishi; nëse është i shëndoshë, i gjithë

trupi është i shëndoshë dhe nëse është i prishur, i gjithë trupi është i prishur. Ajo është zemra.”¹

Fjala “zemër” ka dy kuptime. Njëra tregon pjesën më vitale të trupit, e cila ndodhet në pjesën e majtë të gjoksit dhe i ngjan një boçe pishe. Për sa i përket strukturës dhe indeve të saj, zemra është e ndryshme nga të gjitha pjesët e tjera të trupit. Ajo ka dy veshore dhe dy barkushe, është origjina e të gjitha arterieve dhe venave, lëviz vetë, funksionon si një motor dhe, si një pompë thithëse, lëviz gjakun nëpër sistemin e qarkullimit.

Në terminologjinë sufiste, „zemra” nënkupton aspektin shpirtëror të zemrës biologjike si qendra e të gjitha emocioneve dhe aftësive (intelektuale dhe shpirtërore), të tilla si perceptimi, vetëdija, ndjesia, arsyetimi dhe vullneti. Sufitë e quajnë atë „të vërtetën njerëzore”, filozofët e quajnë atë „vetja e të folurit”. Natyra reale e një individi gjendet në zemër. Në lidhje me këtë aspekt intelektual dhe shpirtëror të ekzistencës, njeriu është në gjendje të njohë, perceptojë dhe kuptojë. Shpirti është thelbi dhe dimension i brendshëm i kësaj aftësie, shpirti biologjik ose shpirti i tij.

Këto dy dimensione janë të ngjashme me njëra-tjetrën. Mund të themi se në të dyja ka një sistem imunitar. Përvojat që fitojmë dhe mënyra se si i trajtojmë qeniet tona fizike dhe shpirtërore rezultojnë në shëndet ose sëmundje.

APOPTOZA

Ne jemi të pajisur me një mekanizëm të balancuar madhështor për të mbrojtur trupin tonë fizik. Sistemi ynë imunitar punon me ushtrinë e tij të madhe për të parandaluar sëmundjet, qelizat e dëmtuara hiqen menjëherë dhe defektet trajtohen përmes mekanizmave elegantë të kontrollit.

Apoptoza është një nga këta mekanizma dhe është i jashtëzakonshëm. Apoptoza është shkatërrimi i programuar i qelizave që janë ose mund të përbëjnë një kërcënim për trupin. Për shembull, qelizat që janë të infektuara me viruse dhe çdo ADN të dëmtuar eliminohen përmes apoptozës. Mutacionet e mundshme në ADN-në qelizore mund të rezultojnë në zhvillimin e kancerit dhe për këtë arsye, shkatërrimi i qelizave të tilla të dëmtuara është vendimtar.

Apoptoza luan një rol të madh në një sërë ngjarjesh patologjike dhe fiziologjike. Formimi dhe liza e qelizave janë më të rëndësishmet nga këto ngjarje fiziologjike. Në indet ku formimi dhe liza e qelizave janë me ritme të shpejta të tilla si lëkura, epiteli i zorrëve, gjaku dhe mëlçia, qelizat e plakjes shkatërrohen përmes apoptozës për të krijuar vend për qeliza të reja. Çrregullimet në ekuilibrin apoptotik u treguan të jenë efektive në disa sëmundje kardiale, sëmundje autoimmune si diabeti dhe çrregullime neurodegenerative si sëmundja e Alzheimerit.

Falë këtij mekanizmi, njerëzit mund të bëjnë jetë të shëndetshme dhe të ekuilibruar. Çdo dëmtim në këtë ekuilibër mund të rezultojë në sëmundje dhe kancere për shkak të përhapjes së ADN-së së dëmtuar. Ndërsa ngarkesa e qelizave që nuk funksionojnë dhe shkalla e dëmtimit të qelizave tona rritet, shëndeti i trupave tanë

fizikë do të bjerë.

Mirëqenia e anatomisë sonë shpirtërore është e ngjashme me mirëqenien e trupit tonë fizik. Dimension i shpirtëror humbet ekuilibrin e tij dhe përkeqësohet për shkak të mëkateve dhe plogështisë.

Prirja jonë e papërllyer është krijuar në mënyrë që ne të mund të njohim, të njihemi nga afër dhe ta duam Zotin tonë. Që sistemi ynë imunitar shpirtëror të funksionojë siç duhet, ne duhet të bëjmë një jetë që është në përputhje me këtë prirje. Për sa kohë që kujdesemi për shpirtin dhe zemrën tonë, sistemi ynë imunitar shpirtëror do të jetë i fortë dhe i pajisur mirë kundër çdo sulmi nga jashtë. Megjithatë, nëse lejojmë që zemra jonë të goditet nga shigjetat e mëkatit, nuk i qëndrojmë larg mjedisit të rrezikshëm ose nuk marrim masat e duhura kundër sëmundjeve, kjo do të hapë rrugën për një deformim të zemrës dhe jetës sonë shpirtërore. Një person që vuan nga një deformim i tillë mund të riformohet ose të rikthehet në disponimin e tij/saj origjinal vetëm duke kërkuar faljen e Zotit. Çdo mëkat e dëbon mëkatarin nga Zoti, duke e afruar më shumë me mosbesimin. Vetëm kërkimi i faljes nga Zoti mund ta ndihmojë një person të heqë qafe mëkatet dhe të largojë njollat e lëna pas nga ato mëkate.²

Nëse ne mund ta trajtojmë siç duhet këtë mekanizëm të kërkimit të faljes nga Zoti, Zoti ynë do të na pastrojë me hirin e Tij të pafund, duke siguruar që ne të mund ta mbajmë jetën tonë shpirtërore në një mënyrë të shëndoshë. “Lutja dhe besimi ndaj Zotit forcojnë shumë prirjen tonë për të bërë mirë, dhe pendimi dhe kërkimi i faljes e mposhtin prirjen tonë për të keqen dhe theyejnë shkeljet e saj,” shkroi Bediuzzaman Said Nursi. Kërkimi i faljes së Zotit është një mundësi për ne për të pastruar shpirtin tonë, një mjet për shërim dhe një mburojë për mbrojtje, ashtu siç është apoptoza për trupin tonë. Edhe Nursi vëren se aftësitë për kryerjen e veprave të këqija mund të zëvendësohen me ato për kryerjen e veprave të mira përmes procesit të kërkimit të faljes nga Zoti.

Këtu duhet theksuar se edhe nëse çdo qenie njerëzore është e pajisur me aftësinë për të njohur Zotin në prirjen dhe ndërgjegjen e tij origjinale, ai/ajo është gjithashtu i pajisur me prirje që mund të përdoren për të mirë ose për të keq në mënyrë që ai/ajo arrin përsosmërinë përmes sprovave dhe mundimeve. Në këtë kontekst, urdhrat dhe ndalesat hyjnore shërbejnë për t'i pajisur qeniet njerëzore me një „disponim të dytë”. Prandaj, një person mund t'i devijojë ato prirje në prirjen e tij/saj drejt së mirës duke iu bindur urdhrave të Zotit.

Mekanizmat për të kërkuar falje dhe apoptozë nga Zoti janë favore hyjnore që na janë dhënë me dashamirësi, në mënyrë që të sigurohet shëndeti ynë shpirtëror dhe fizik. Sa më shumë t'i kërkojmë falje Atij, aq më të shëndetshëm do t'i gjejmë shpirtin tanë dhe ndoshta edhe trupin tanë. Ne duhet të shpresojmë se mund të përparojmë si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër si mjekët, të cilët, duke përfutur nga shkencat moderne dhe fetare, mund t'i çojnë pacientët tanë drejt shërimit të vërtetë.

Përktheu: Erion Sukaj

1. Buhariu, Iman, 39; Muslimi, Musakat, 107

2. Tirmidhiu, Tefsir el-Surah (83), 1.

ELEFANTI HERO

Vapa e mesditës po ndihej gjithnjë e më shumë. Lëvizjet ishin pakësuar. Të tërhequr nëpër fole ose në vende të freskëta, kafshët po e kalonin vapën duke dremitur. Kudo sundonte heshtja.

Edhe Elefanti i Madh ishte shtrirë nën një pemë të gjerë. Ai po pushonte duke prituri të kalonte vapa. Herë pas here mbledhte rrëzë me feçkë dhe ia lëshonte kurrizit. Kështu ai bënte banja rëre dhe pastronte kurrizin nga insektet.

Pasi mbaroi banjën, Elefanti i Madh hodhi një vështrim me bisht të syrit përreth: drurë të mëdhenj, shkurre, pemë të reja dhe plot gjelbërim. Pak më parë Elefanti i Madh kish ngrënë disa kilogram bimë dhe ishte ngopur mirë, por ç'e do se kishte kohë pa pirë ujë dhe tani e kish marrë etja.

Përreth s'dukej as lumë e as ndonjë pellg uji. Elefanti ngriti feçkën lart dhe nuhati ajrin. Feçka e tij e fuqishme me të cilën mund të shkulte nga vendi drutë të mëdhenj, ishte po aq e ndjeshme sa të nuhaste kundërmimin e ujit që shumë larg përtej.

"Hëmmm..." foli Elefanti me feçkën. "Pas kësaj kodre vjen kundërmim ujit!"

Duhej të shkonte atje. Sapo do të ngrihej në këmbë, u dëgjua një zë i hollë që vinte nga lart përmes nën të cilën kishte ndenjor shtrirë gjer tani:

"Ej, xhaxha elefant, a po më dëgjon pak?"

Elefanti plak ktheu kokën rëndë-rëndë sa andej-këtej, por s'pa gjë. Kush po i bënte zë, vallë?

"Këtu, këtu jam!"

Elefanti plak e hodhi vështrimin lart. Mbi degën mu mbi kokë po rrinte një ketër i vogël. Dukej shumë i këndshëm me atë bishtin ngjyrë kafe të madhe sa ç'ishte vetë dhe me sytë që i shkëlqenin. Ndërsa brente arën që e mbante me një dorë, buzëqeshte ëmbëlsisht.

"A ti je, more vogëlush, që më fole mua? Ç'është?"

"Xhaxhi elefant", i foli tani më me përkëdheli ketri elefantit plak, "të pashë se si i more erë ajrit pak më parë. Më ka thënë mami se ju, elefantët, mund ta ndjeni ujin nga një largësi e madhe."

"Posi! Jo vetëm kaq! Me këta veshë të mëdhenj, ne mund ta dëgjojmë edhe shushurimën e ujit!"

"Oh, sa mirë!"

"Po, po! Kjo aftësi ka një vlerë shumë të madhe për ne. Po të mos na e kishte falur Zoti këtë të mirë, mund të them se do ta kishim të pamundur të jetonim. Po të mos e ndjenim nga shumë larg se ku ka ujë, për ne do të ishte shumë e vështirë të vraponim me gjithë këtë trup

të madh që kemi me orë ose ditë të tëra në kërkim të ujit. Zoti është me të vërtetë shumë i mëshirshëm!"

Me sytë që tani po i shkëlqenin edhe më shumë, ketri i tha elefantit:

"Zoti i do shumë ata që ndihmojnë të tjerët, sidomos atyre që janë më të fuqishëm, apo jo!"

"Posi, ashtu është, ketrash!"

I përkëdhelur, ketri u hodh:

"E pra, xhaxho, merrmë edhe mua te burimi i ujit që edhe ty Zoti të të dojë më shumë! Oh, sa më ka marrë etja!"

Elefanti plak qeshi me gjithë zemër! E qeshura e tij e fuqishme buçiste nga feçka e gjatë që i e përdore si bri. "Qenka ketër i zgjuar, mistrecil!" – mendoi elefanti plak.

"Eja, hipmë mbi kurriz!", i thirri ketrit.

"Pse të të mundoj", i tha ketri. "Po vij më këmbë."

"Jo, more, ç'mundi thua!", ia ktheu elefanti. "Ti je aq i vogël, aq i vogël, sa një thua! Pa le që më bën edhe shoqëri!"

Ketri i vogël u hodh me shkathtësi nga dega e drejt e mbi kurrizin e elefantit.

"Faleminderit, xhaxho!"

"S'ka gjë, vogëlush!" ia ktheu elefanti.

Dhe u vunë në udhë që të dy drejt vendit ku kishte ujë. Kishin gjithë atë rrugë përpara. Do t'u duhej t'i ngjiteshin asaj maje e të zbrisnin në anën tjetër!

Ketri i vogël i foli elefantit plak me zërin e tij të hollë prej ketri

"Po deshe, prezantohemi. Mua më thërrasin Ketrush. Po ty si të quajnë?"

"Elefanti Plak."

"Ooo", e zgjati zërin me habi Ketrushi duke i hapur edhe sytë sikur të donte të sigurohej se elefanti mbi kurrizin e të cilit po udhëtonte, ishte ai për të cilin kishte dëgjuar aq gjëra të çuditshme. "Ti je ai elefanti i famshëm?"

Elefanti Plak qeshi.

"Po", tha. "Edhe ti paske dëgjuar për mua!"

Ketrushi ishte prekur. Zemra e vockël i rrihte fort nga gëzimi dhe krenaria për mikun e madh.

"E kush nuk të njeh ty, o Elefanti Plak! Historia jote kalon gojë më gojë të kafshët. Sa do të desha ta dëgjo tani nga goja jote!"

Duke u çapitur rëndë-rëndë e duke i lëvizur veshët e mëdhenj si freskore, Elefanti Plak i tha Ketrushit:

"Posi! Edhe rrugën e kemi të gjatë!"

Pasi mori frymë thellë, Elefanti Plak nisi të tregonte:

"Shumë vite më parë unë merrja pjesë në ushtrinë e Negusit, sundimtarit të Etiopisë. Tani jam plakur, por atëherë isha elefanti më i madh e më i fuqishëm në botë.

Mua më përdornin në luftë. Ja, si tanket e sotëm. Një ditë prej ditësh, më përgatitën sërish për luftë, por jo me ushtrinë tonë. Unë do prija ushtrinë e Ebrehesë."

"Kush ishte ky Ebreheja?", pyeti Ketrushi.

"Guvernatori i Jemenit!"

"Ç'njeri ishte ai?"

"I keq, shumë i keq!", foli me përbuzje për të Elefanti Plak. "Siç pata dëgjuar, nuk e duronte dot që njerëzit të shkonin turma-turma në Qabe për pelegrinazh. Për ta penguar këtë, ai kishte ndërtuar një tempull të madh, të bukur e të stolisur me ar e argjend. Por ja që njerëzit s'donin të shkonin te tempulli i tij. Kurse numri i vizitorëve të Qabesë shtoej çdo ditë e më shumë. Kur arabët e kishin marrë vesh qëllimin e Ebrehesë, ishin zemëruar shumë. Njëri prej tyre kishte shkuar një natë dhe e kishte dëmtuar tempullin. Ebreheja ishte egërsuar. Ai ishte betuar:

"Arabët ma bënë këtë se nuk e dua faltoren e tyre! Po edhe unë s'do të rri. Gur mbi gur s'kam për të lënë në Qabe."

"O Zot, ç'njeri i keq që paska qenë!", tha me hidhërim Ketrushi.

"Në atë kohë, prijësi i fisit Kurejsh të Mekës ishte Abdulmutalibi."

"Ashtu? Gjyshi i Profetit Muhamed?", pyeti i habitur Ketrushi.

"Ai vetë! Muhamedi nuk kishte lindur ende. Kur i ishin afruar Mekës, Ebreheja i kishte çuar fjalë me përfaqësuesin e vet Abdulmutalibit se kishte ardhur për ta shembur Qabenë."

"Po Abdulmutalibi ç'kishte thënë?"

"I kishte thënë se faltorja e Qabesë ishte Shtëpia e Allahut, siç e quanin të gjithë, dhe se Ai do ta mbronte. Pastaj Abdulmutalibi i kishte kërkuar përfaqësuesit të Ebrehesë t'i kthente dyqind devetë që ia kishin rrëmbyer ushtarët e tij disa ditë më parë kur po kullosnin në fushë.

Ebrehenë e kishin çuditur shumë fjalët e Abdulmutalibit që, në vend që të shqetësohej për Qabenë që do të shembej, e t'i dilte për zot si prijës i fisit që ishte, shqetësohej për devetë! Abdulmutalibi kishte thënë atëherë ato fjalë që do të mbeteshin në histori:

"Unë jam i zoti i deveve, kur i Zoti dhe Mbrojtësi i Qabesë është Allahu. Ai ka për ta mbrojtur Qabenë!"

Ebreheja e rreshtoi ushtrinë për të hyrë në qytet.

"Po populli, ç'bëri?", ia ndërpreu Ketrushi fjalën Elefantit Plak.

"Populli u largua nga qyteti për në kodrat përreth dhe vende të tjera të sigurta. Qyteti i Mekës u zbraz krejt."

"Po ti, ç'bëre, o Elefanti Plak?"

"Unë ndodhesha, si gjithmonë, në krye të ushtrisë. Kur ushtria do të nisej, më erdhi pranë udhërrëfyesi, Nufejli, dhe më pëshpëriti në vesh:

"Ulu e mos lëviz vendit në daç të kthehesh që këtë shëndoshë e mirë! Këtu është qyteti që Allahu e ka quajtur të shenjtë!"

Unë e kuptova menjëherë se si qëndronte puna. Mua donin të më përdornin për qëllime të mbrapshta! Dhe u

ula menjëherë përtokë."

"Mirë, po ushtarët, a s'u përpoqën të të ngrinin në këmbë?"

"Sa shumë u munduan, thuaj, Ketrush. Ushtria kishte edhe elefantë të tjerë, por unë duhet të prija. Ata s'mund të bënin asnjë hap pa mua. Por pa dobi. Kur më kthenin nga Qabeja, s'lëvizja nga vendi, kurse kur më kthenin në drejtim të kundërt, ngrihesha menjëherë për të ikur. Ata s'po kuptonin asgjë. S'kishte ndodhur kurrë më parë kështu me mua."

Ketrushi kishte çapëlyer sytë e dëgjonte me kureshtje të madhe.

"Mu në mes të këtyre përpjekjeve, ndodhi më e madhja."

"Ç'ndodhi?", s'u durua Ketrushit.

"Për një çast, qiellin e mbushën shpendë të egër që u thonë "Ebabel". Secila kishte nga një gur në sqep e në të dy këmbët. Shpendët zbrisnin poshtë me shpejtësi e i lëshonin gurët mbi ushtarët e Ebrehesë. Ushtari që e qëllonte guri, rrëzohej i vdekur në vend."

"Po Ebreheja?"

"Edhe atë e goditi një gur dhe vdiq."

"Po ti, si shpëtove?"

"Ç'të të them? Mbi mua s'u lëshua asnjë shpend, s'ra asnjë gur. Dhe ja tek më ke gjallë këtu, para sysh."

"Po pastaj?"

"Pasi u larguan shpendët, ia nisi një shi me rrebesh. Rrëketë e ujit i morën me vete kufomat e i lëshuan në det. Vendi u pastrua si më parë. A e di, o Ketrush, se për këtë ngjarje bëhej fjalë edhe në Kur'an? E kam dëgjuar me veshët e mi. Ja se si përshkruhet ajo ngjarje e mahnitshme.

Zoti i drejtohet Profetit Muhamed:

"A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me pronarët e elefantëve? A s'bëri që të dështojnë planet e tyre? Lëshoi mbi ta zogj tufa-tufa që i qëllonin me gurë prej argjile të pjekur. Dhe e bëri ushtrinë e tyre si një arë të lashtash të shkelur e të copëtuar!"

Ketrushi që e kishte ndjekur rrëfimin e Elefantit Plak pa e lënë t'i shpëtonte asnjë hollësi, e kishte kuptuar se Allahu i ndëshkonte të këqijtë, ndërsa të mirët i mbronte.

"Të faleminderit shumë, Elefanti Plak", i tha ai Elefantit. "Kurrë s'kam për ta harruar këtë ndodhi."

Ndërkaq ata kishin arritur tek uji. Atje pinë gjersa u ngopën dhe e falënderuan Allahun, që u falte shumë të mira e i mbronte.

Tanimë Elefanti Plak dhe Ketrushi ishin bërë miq të ngushtë.

Ç'kuptuat nga kjo ndodhi?

-Si e gjente Elefanti i Madh se ku kishte ujë?

-A ia dhënë Zoti çdo gjallesë gjërat për të cilat ka nevojë?

-Përse e ndihmoi Elefanti i Madh Ketrushin?

-Ç'dini për Qabenë? Kush është Ebreheja?

-Pse e ndëshkoi Allahu Ebrehenë?

-Si shpëtoi Elefanti i Madh nga gurët e shpendëve të egër Ebabel?

-Ç'bënë Ketrushi dhe Elefanti i Madh pasi pinë ujë?

-Po ju, a e falënderoni Allahun, Zotin tuaj, për të mirat që ju ka dhënë?



Standarte bashkëkohore sipas rregullave qiellore!

PAMJE PANORAMIKE
USHQIM HALLALL
DHOMA ÇIFT, TRESHE & SUITA


BLUE ORCHIDEA
HOTEL

 Uji i Ftohtë, Vlorë

 www.blueorchidea.com

 069 565 3323